

Oral History Kosovo

INTERVISTË ME OSMAN OSMANIN

Prizren | Data: 2 maj, 2018

Kohëzgjatja: 116 minuta

Të pranishëm:

- Osman Osmani (I intervistuari)
- Drenushë Morina (Intervistuesja)
- Elmedina Arapi/ Gençer Tatar (Kamera)

Simbolet e komenteve në transkriptë te komunikimi jo-verbal:

() - komunikim emocional

{ } - i intervistuari shpjegon me gjeste

Simbole të tjera në transkriptë:

[] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin

Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.

Pjesa e Parë

Drenushë Morina: Atëherë a mundeni me na tregu fillimisht me u prezantu emrin, mbiemrin, datën, vendin e lindjes?

Osman Osmani: Quhem Osman Osmani, kam lindë me 12 shkurt, 1962-tës në fshatin Mlik, Komunën e Dragashit. Prej vitit '63, 1963 jetoj në Komunën e Prizrenit këtu. Jam pjesëtar i komunitetit rom, me profesion jam inxhinier i tekstit një pjesë e bukur të jetës teme apo rinisë teme kam qenë i punësuar në industrinë e tekstit "Printeks", ka qenë një sipërmarrje goxha e madhe që na i ka punësu dikun afër tre mijë punëtorë. Edhe kam qenë inxhinieri i parë i komunitetit rom, i cili është punësu në këtë sipërmarrje edhe mu është dhënë rasti prej vitit 1985 ta, ta menaxhoj një pjesë të "Printeksit" edhe të njerëzve edhe komplet procesit në kuadër të kësaj sipërmarrje.

Drenushë Morina: Para se me dalë edhe më vonë te karriera e ju, a mundeni me na tregu diçka rreth fëmënisë tuj tu fillu ndoshta prej kujtimit ma të hershëm që ju e kujtoni, diçka të veçantë?

Osman Osmani: Prej... në rend të parë, unë sikur që edhe parës e përmenda me qenë prizrenas e mos me njoftë gjuhën turke osht' shumë problem. Une fillimisht kur jonë shpërngulë prindërit e mi këtu në Prizren, kemi banu me një lagje tjetër. Këtu po ju tregoj '63-tën, '64-tën edhe ka qenë kryesisht kultura përveç gjuhës tënde që duhesh me flas, të folish, ta njohish edhe gjuhën turke sepse ka qenë njëfarë niveli i qytetarijës nëse je ti edhe pjesë e këtij e kësaj gjuhë. Muj me të thanë që unë deri në fillim të shkollës fillore, shokët e mi po edhe ata që jom shoqëru në atë moshë edhe kemi bisedu edhe jemi shoqëru në këtë gjuhë.

Me kalimin e kohës, në moshën gjashtë vjeçare prindërit e mi kanë kalu në lagjen e romëve, domethënë këtu ku jemi sot edhe pak a shumë gjuha rome, gjuha rome ka qenë kryesore që është folë. Përveç gjuhës që jam shkollu por apet në shoqëri me tjerët domethënë komuniteti rom është deshtë përveç tri gjuhëve, gjuhës serbe, gjuhës shqipe dhe gjuhës turke taa... unë e kom njoftë

domethënë edhe gjuhën rome edhe i takoj një pjesës së komunitit e cila... bukur gjithë i njohin. Domethënë, te katër gjuhët këtu në Komunën e Prizrenit.

Shpesh e përdorim edhe këtë fjale, “Që fëmija i komunitetit rom kur të lind, ajo i din meniherë katër gjuhë”, sepse e kërkon rrethi këtu dhe na nuk e kemi këtë problem. Ajo që osht’ interesant të përmendet osht’ se une kom pasë shumë dëshirë me... të vazhdoj të shkollohna, sepse i shihsha si fëmijë gjeth fëmijët me çanta në krah e shkojshin në shkollë edhe une i kom pasë kërku pi... kom insistu atëherë te prindërit, te nona ime edhe te babai të më regjistroj domethënë sa më shpejtë në shkollë. Edhe ata bojshin, më bonën presion, sepse përpara fillojshe me shtatë vjet une me gjashtë vjet fillova në shkollë sepse nuk i lojsha, dëshirojshe edhe une ta regjistroj.

Por ajo njëra prej sfidave atëhere në fillim që shumicën e komunitetit rom osht’ ballafaqu me këtë realitet osht’ që shumica e prindërve kanë qenë jo të arsimum mjaft apo edhe analfabetë, edhe ndihma e fëmijës karshi fëmijës në shtëpitë e atynve në familjet e atynve ka qenë shumë e doptë e ultë apo mos të them fare. Nuk ka mujt me ekzistuar sepse vetë prindëri jo i arsimum mjaftueshëm, jo i arsimum për m’i arritë m’i ndihmu fëmijës vet. Edhe... por ajo që çdo herë më ka metë e regjistrueme në tru si një segment edhe ka qenë një shtytës edhe për mu për me vazhdu mi motivu fëmijë e mi, ka qenë momenti kur nëna ime çdo herë më ka përcjellë edhe deri në shkollë edhe në kthim prej shkollës.

Edhe shka ka qenë interesant, ajo e ka ditë njëfarë rendi që prindërit duhet të... domethënë m’i përcjellë fëmijën m’i bo detyrat edhe ajo kërkojke domethënë mas kthimit tim nga shkolla t’i bëj detyra të shkruaj, t’i bëj detyrat e matematikës apo të shkrimit, të leximit. Edhe une deri në klasën e dytë apo edhe tretë, vërtetë nuk e kam ditë që nonën e kam analfabete sepse ajo çdo herë rrike përmi kry tem, unë t’u kujtu që ajo p’e din çka jam t’u bo, çka jam t’u shkrujt, çka jom t’u lexu, t’u kujtu se ajo p’e kupton. Ajo çdo herë domethënë më përcillke ato çka e bojsha në fletore, qoftë matematikë ose qoftë në shkrim, por çdo herë më thojke, “Po mirë osht’”, une t’u kujtu se ajo pe din çka jam t’u bo.

Derisa, dytën, tretën klasë e kuptova që nënën e kam analfabete e ajo fare nuk po dike se çka jam t’u bo, por dëshira e saj që fëmiju i vet të arrin njëfarë niveli te arsimimit të motivon të më jep kurajo të ma ofron kulturën e arsimimit, të më vetëdijëson sa osht’ arsimimi i rëndësishëm. Domethënë, ka qenë prej klasës parë deri në... thujse deri në klasën e tetë, ajo domethënë përcjellja e asaj ka qenë tanë kohën edhe falë të atij angazhimit të asaj domethënë mu... une vet si person arrita domethënë t’i tejkaloj të gjitha ato barriera, sepse normal ka qenë shumë problem të arrish njëfarë niveli të arsimimit, të shkrimit, të leximit edhe të gjitha atyre njohurive që duhesh me përfitu në shkollë fillore.

Por çdo herë nuk ki mujt ato në shkollë me i arritë, po asht’ deshtë edhe dikush me të kontrollu, në këtë rast prindërit, prindërit kanë qenë... nuk kanë qenë në situatë këto me konifrmu por thjesht ai motivi i atyne më ka shty që unë duhet të mësohna duhet të arrij edhe normal atëherë edhe vazhdimi i shkollës mesme nuk ka qenë në pyetje edhe vazhdimi i studimeve. E mbaj mend atëherë kur ‘80-ën unë e përfundova shkollën e mesme, atëherë ka qenë rendi, sistemi ashtu se u duke me shku ushtar,

shërbimin ushtarak ta përfundojsh edhe nëse e ki regjistru studimet ti ki pasë domethënë mundësi, domethënë një vjet te studiojsh edhe të vazhdojsh studimet. Une ndërkohë e pata regjistru studimet ajo që osht' interesant për prindërit kanë qenë shumë...

Prindërit e mi kanë qenë shumë në rregull që unë te vazhdoj shkollimin tem, vazhdoj studimet, edhe pse në atë kohë domethënë osht' deshtë goxha të largona prej Prizrenit, sepse në Prizren jo si sot që i kemi universitetet na i kemi pasë... pat vetëm një shkollë të Lartë Pedagogjike, e cila i përgatitke arsimtarët, mësimdhënësit për nivelin e caktuar. Si tash që i kemi domethënë edhe mundësitë edhe ekonomisë edhe juridikës edhe shumë... shumë lëndëve tjera e degëve tjera... e u duke për atë që pata përfundu shkollën e mesme të shkoj deri në Beograd. Arrita të regjistrona me kohë, isha në listë goxha i lartë në bazë suksesit dhe ka qenë një sfidë atëherë për mu, sepse studimi në krahasim me shkollën e mesme, fillore, ka qenë krejtësisht diçka tjetër.

Nuk ka qenë përgatitja e mësimi për nesër me dhanë por osht' deshtë gjashtë muaj m'u ndëgju një, një lëndë e caktuar apo një vjet edhe të dalish në provim. Atëherë veq osht' deshtë domethënë tamam në fjalë të kuptim plotë ta studiosh lëndën, të përgaditesh seriozisht edhe domethënë të të japish atë provim. Kam pasë fat që edhe në shkollë të mesme, arsimtarët sidomos që i kam pasë në lëndët profesionale kanë qenë njohës të të materies së vet edhe ajo më ka ndihmu që në... kur kom vazhdu të studioj domethënë në Beograd, shumica e këtyre njohurie veç i kom pasë ashtu që edhe me profesorët me të cilët kom pasë punë, domethënë në atë kohë shumica e atyre kanë qenë magjistër ose doktor i shkencave të tekstilit kanë kuptu që domethënë e kom një bagazh, një njohuri të majftueshme që e kom përfitu këtu në Prizren edhe domethënë prej meje ka gjasa të del diçka ma cilësore edhe në vazhdim të jetë kualitet.

Ajo që osht' reflektu tek unë, domethënë që qajo... qaj zinxhiri i cili asht' tanë kohën tek komuniteti rom i kputun, sepse filozofia jeme pak a shumë osht' që një popull që osht' i arsimum ka gjasa, ka mundësi domethënë të përparon, ka mundësi të jetë i barabartë me tjerët sepse në mënyrë... kur je i arsimum i edukum ti je i kapacitetit majftueshëm që të jetë, të jesh në gjendje të luftosh për të drejtat e tua, të jesh i barabartë me tjerët, t'i njofish sendet. Edhe normal problemet, sfidat mujsh shumë ma lehtë t'i eliminojsh apo t'i zgjedhish edhe kjo domethënë vazhdim ka qenë domethënë një pjesë e punës time kur osht' fillu të punoj unë vet me fëmijët e mi.

Domethënë kur është kriju familja, kur jam punësu edhe kriju familja domethënë kom pasë edhe... Unë kam tre fëmijë edhe n'atë kohë e kom dit sa është me rëndësi prindërit. Prindi t'i jep kurajë, t'i jep mbështetje fëmijëve, por pak a shumë me provu me i ndihmu në detyra sepse këte mënyrë i jepet mbështetja fëmijëve edhe i ngritët vetëdija se a është e rëndësishme, sa është e rëndësishme arsimimi në përgjithësi. Këto jonë ato pjesë të cilat edhe sot shpesh i përdori kur bisedoj me prindërit, por edhe kur bisedoj me shumë fëmijë, sepse tash jom i orientum të them punoj me fëmijët në arsimimin e fëmijëve rom edhe shpesh kur kontaktoj me prindërit sidomos edhe me fëmijët e atynve mundona që shumë përvoja tjera, por ndër tjera edhe këtë përvojë ta përcjelli tek ata, sepse nuk osht' e

rëndësishme për çdo herë të jesh i arsimum, nuk osht' e rëndësishme çdo herë të jesh i nivelit të lartë të arsimit.

Thjeshtë osht', osht' nevojshme të dish rëndësisjen e arsimimit, ta dish mënyrën se duhet të krijohet një kontakt, një komunikim me fëmijët e tu, dhe te ata të krijohet njëfarë besimi që ata mujnë të jenë në gjendje, mund ta arrijnë ndryshimin edhe jonë në gjendje të arrijnë ndryshimin e vet edhe në këtë mënyrë domethënë t'i krijohen mundësitë e zhvillimit të atyre. Normal gjithë i kemi na mundësitë e tona, i kemi kapacitetet tona të ndryshme. Edhe çdo fëmijë nuk ka mundësi të përfundon aty ku dëshiron, por së paku të krijohet mundësitë çdo fëmijës në bazë të kapaciteteve të veta të brendshme që të arrijnë atë detyrë apo dëshirë që e ka në të ardhmën. Këta jonë çështjet të cilat une apat po them çdo herë i përmendi edhe i përkujtoj tek prindërit edhe fëmijët, sepse për m'i eliminu varfërijën, për m'i eliminu papunësinë, për m'i eliminu shëndetin e dobët, për m'i eliminu problemet sociale, për m'i eliminu shumë dukuritë negative për mu cilin osht' arsimim.

Duhet të sakrifikon çdo prindër një kohë gjatë, sepse ky proces kërkon investim të gjatë. Minimum 12, 14, 16 vite, por në fund prindi do të jetë shumë i gëzueshëm, shumë i lumtur, nëse e shef fëmijën e vet që është i gatshëm, i aftë që të fillon edhe vet me u marrë me problemet edhe zgjidhjen e problemeve të ndryshme. Kjo është njëra prej çështjeve të cilat besoj se në Prizren mund të them edhe pse unë... Prizreni ka qenë... në kuadër të Prizrenit ka pasë shumë romë të arsimuar me nivel të lartë, në kuadër të komunitetit rom ka pasë njerëz edhe me... edhe mjekët, ka pasë edhe jurista, kemi pasë edhe prokurorë, kemi pasë gjyqtarë, kemi pasë avokatë, kemi pasë inxhinierë, ka pasë ekonomista, ka pasë shumë njerëz që Prizreni osht' veçu. Domethënë, sa i përket edhe Kosovës edhe pjesës Ballkanit që romët i japin njëfarë rëndësie të veçantë çështjes se arsimimit.

Kjo është tentu duke pasë parasysh që tash Prizreni me një mënyrë e ka një përparësi, sikur që e thashë përpara këtu e kemi universitetin dy hapa prej shpijes. Na nuk e kemi pasë atë luks para 30-40 viteve me pasë universitetin para hundës, tash e kemi para hundës këtu. Shkollat e mesme i kemi këtu, gjitha këto janë këtu afër në... i vjen era dijuni, njohuri, shkencë e ti mos me i shfrytëzu, mos me qenë pjesë e asaj është mëkat, shumë mëkat i madh. Une gëzova që ma s'pari në familje teme që ka fëmijë që jonë... dy fëmijë të mëdhaj më kanë kry shkollë të mesme, por vajza e vogël është në fazën e diplomimit. Ajo i ka kry krejt, të gjitha provimet, tash asht t'u përgatit punën e diplomës që i jep domethënë që nuk kom punu kot, domethënë kom arritë.

Por, unë me kolegët tjerët, krejt shoqëria në përgjithësi falë shumë aktiviteteve që i kemi zhvillu këtu, ne i kemi në Komunën e Prizrenit diku afër njiqind studentë të komunitetit rom që momentalisht studiojnë. Kemi në bazë njohurive nja katër-pesë që jonë në proces magjistraturës. A unë i kom evidencat prej vitit 2008 deri sot, deri vitin e kaluar që dikun 34 apo 35 kanë diplomu. Domethënë, po i jep një shpresë që kjo rrota kadal-kadal ka fillu me lëvizë, se ai dhëmbëzor tash po kthena te ajo profesioni jem inxhinier, ata flasin me dhëmbëzore flasin me formula, por ka fillu domethënë

dhëmbëzori te lëvizë edhe është problem tash me nal atë dhëmbëzori se ky dhëmbëzore do t'i krijon, do t'i lëvizë edhe dhëmbëzore tjerë, edhe fëmijët tjerë.

Normal, ky proces osht' i gjatë duke ditë se komuniteti rom ballafaqohet me shumë probleme, ballafaqohet edhe me çështje në kuptimin shëndetësor edhe social, diskriminimet direkte, indirekte, të fsheta, të hapuna. Kur të flasi këto, flasë jo vetëm në nivel të... jo vetëm për Prizren por edhe në nivel të Kosovës, flasi për nivel të Europës. Ka shumë vende që haptas i diskriminojnë komunitetin rom, i sulmojnë, nuk i japin mundësi apo thjeshtë krijojnë mundësi që ata të largohen prej shkollës, të largohen prej punësimit, të jenë të rrugëve. Nuk e di, najherë nuk po muj me kuptu qëto shtetet ku ndodhin këto rastet e diskriminimit të hapët që komuniteti thjeshtë osht' pjesë e rrugës, osht' pjesë e padrejtësisjës, e ai nuk osht' në gjendje të luftoj për veten, nuk është në gjendje të ngrit zërin e vet.

Në anën tjetër, të jetë pjesë e ndihmës sociale që une personalisht jam shumë kundërshtar i madh i ndihmës sociale. Shpesh në takimet që zhvillohen edhe këtu në Prizren edhe në nivel qeveritar folët për varfërijën, folët për ndihmën sociale, për mirëqenien sociale të familjeve. Një ndihmë sociale për një familje tre-katër-pesë anëtarëshe osht' diku 80-90 euro, e tash nëse flasim haptas a mundet një familje me 80-90 euro me mbijetuar jo, osht' vetëm mashtrim që një familje tri-katër anëtarëshe ku i ka një apo dy fëmijë në shkollë mundet me 80-90 euro me mbijetu. OK, i ka lehtësimet në rrymë, i ka lehtësimet në ujë, në këto shpenzime tjera, po apet me 80-90 euro nuk mundet me mbijetu. Por në anën tjetër ajo që është me e keqja e kësaj, e këtij procesit osht' që edhe që i jipet ndihmë sociale, shteti nuk po mendon për politikat stimuluese.

Nëse një familje e merr një ndihmë sociale në nivel prej, nuk e di, 80-90 euro, pse ajo të mos jetë e angazhuar me një punë të caktuar. Për shembull, një ore ose dy orë në javë edhe në këtë mënyrë ta pagon vetin, sepse jo vetëm që e pagon vetin po ajo edhe e edukon fëmijën e vet që vetëm nëpërmjet punës ti mujsh me siguru ekzistencën tonde edhe mujsh e shku ma tutje. Gjithë ne po marrim ndihmë sociale, po marrim mirë, por ajo fëmija, fëmija e asaj familje ajo pe merr atë edukatë, atë njohuri që OK jeta po varet krejt prej ndihmës sociale edhe po duhka qashtut me jetu, kjo po duhka me qenë kultura e jetës time në të ardhmen, une të jetoj prej ndihmës sociale. Jo!

Nuk guxojmë të jem pjesë e ndihmës sociale. Ok ka familje që duhen të mbështetën duhet të jepet ndihma sociale 80, 90, 100, 200 euro sa kanë nevojë, por një pjesë e asaj familje duhet me kontribu për atë që ka marr atë ndihmë sociale, se edhe ajo ndihmë sociale është marr prej dikujt, osht' marr prej naj tatimit, prej naj kontributit najkujt edhe ajo të arsyetohet. Në këtë mënyrë edhe ajo familjari edhe ajo fëmija duhen te mësohen që vetëm mujsh me jetu, mujsh me mbijetu, mujsh me siguru ekzistencën ma të mirë nëse punojsh e nëse punojsh, dush punë ma të mirë, ma të pagune, ti duhesh me qenë i arsimum. Domethënë, një zixhir që lidhet njeni me tjetrin edhe në këtë mënyrë i jep mundësi që të vazhdohet edhe të sigurohet ekzistenca edhe përmirësimi i pozitës se komunitetit n'përgjithësi.

Drenushë Morina: Përmendët edhe kur jemi te familja, përmendet që prindërit sidomos nona ka qenë një motiv i madh për ju që me vazhdu shkollimin. Sa anëtarë keni qenë edhe në atë kohë në familje edhe vëllezërit, motrat a e kanë ndjekë shkollën?

Osman Osmani: Në atë kohë për fat të mirë edhe pse për Kosovë thonë që janë familje të mdhaja gjashte, shtatë, tetë, nëntë, dhjetë anëtarë, na kemi qenë pesë anëtarëshe, familje pesë anëtarëshe. Domethënë, prindërit edhe tre fëmijë, ashtu që ka pasë hapësirë mjaftushëm domethënë unë edhe dy motra ka pasë mjaft hapësirë që prindërit te orientohen kah edukimi i fëmijëve te tynve edhe t'i përcjellin, edhe t'i ndihmojnë, edhe t'i mbështesin, edhe motrat e mia kanë përfunduar. Motra e madhe ka përfunduar shkollën e mesme, më doket që ka qenë dega e tregtisë që e ka përfunduar, po ka qenë dedikimi komplet asaj familje, prindërve të mi, të jenë të arsimuar edhe të përfundojnë njëfarë shkollimi se vetëm në atë mënyrë mujsh me siguri ekzistencën edhe për ato që është thelbi i krejt kësaj bisede edhe natyre që jemi t'u bisedu.

Edhe une vet kam qenë pjesë domethënë familja, bashkëshortja edhe tre fëmijë ashtu që edhe une kam qenë në gjendje vërtetë të provoj të kontribuoj tek fëmijët e mi, tek edukimi i atynve edhe tek arsimimi i atynve. Për fat të keq, në komunitetin rom ka familje me gjashtë, shtatë, tetë fëmijë edhe jonë në pozitë shumë të palakmueshme, sepse ngarkesa për me siguri ekzistencën, ngarkesa për me siguri kafshatën e bukës në rend të parë, veshëmbathjen, diqysh e kom vërejtë që arsimimin e qet diku tretën, katërtën apo pestën shkallë të prioriteteve tek këta familjarët. Edhe vërtetë e kanë një problem goxha të theksuar, domethënë arsimimit të fëmijëve të atynve, po thjesht në këtë... tash kur të flasim për këto 15-20 vitet e fundit, jemi me një situatë që shoqëria civile, rrethi, mekanizmat e ndryshme që ekzistojnë duhet me provu me i ndihmu familjarët, edhe duhet me i afëru mundësitë edhe atyne familjeve që jonë me shumëanëtare, shumë fëmijë m'i mbështet edhe m'i përkrahë për me vazhdu shkollimin atyne.

Sidomos ma s'pakti shkollimin e mesëm, po them për fat keq po shoh edhe si një dobësi që ende shkollimi i mesëm ende nuk osht' i obliguar, të kish qenë i obliguar edhe shkollimi i mesëm bon vaki kish qenë shumë ma lehtë domethënë t'i inkurajojmë apo t'i bëjmë presion edhe institucioneve të arsimit, edhe për shembull Qendra për Punë Sociale t'i kushtëzon qata familjarët që duhesh një ndihme sociale, fëmija jot t'i duhesh me na pru... ti duhesh me na pru një vërtetim që fëmija jote osht' t'u vijë shkollimin e mesëm. Domethënë, me rend të gjitha ato mekanizmat që i ndihmojnë ngritjen e vetëdijes tek familjarët për arsimimin, rëndësisht e arsimimit. Shoqëria civile e përmenda ma herët që ka ndryshime në Prizren, ekziston, pra ndodhin.

Çdo vjet jonë dikun pesë deri në gjashtë studentë që jonë afër diplomimit apo po diplomojnë në krahasim me një numër prej 5500 romëve sa jetojnë në Prizren. Nuk o një numër serioz, por apet po thom, osht' një numër që i inkurajon që ndryshimet do të ndodhin edhe gjitha ato pengesat apo problemet me të cilat jonë ballafaqu prindërit e atynve me siguri do të jenë ma të vogla. Mos të tham të eliminojmë por ma të vogla te këto familje të cilat apo të rinjtë të cilët diplomojnë edhe jonë shumë

me të përgatitur për jetën në të ardhmen. Kjo, kjo, këto e shoh si shumë çështje e rëndësishme të cilën edhe duhet të bisedohet, edhe duhet të preket edhe nuk e di do të mundona deri sa jom në gjendje edhe të punoj në këtë drejtim, të jap kontribut në këtë drejtim edhe të vetëdijesojë komunitetin tim.

Po them, në kuadër të organizatës ku veprojmë jonë diku për moment 30 studentë të angazhum në mënyrë vullnetare, ata punojnë nëpër shkolla, me nxënës shkollave fillore. Përveç njohurive që i përcjellin tek këta moshatarët në mënyrë indirekte, ata edhe njëherë i punojnë ato materialet për cilat janë t'u mësu, janë t'u studiju. Ashtu që edhe me një mënyrë simbolike mbështetën, në mënyrë financiare studimi i atynve, japin një kontribut të rinjve, japin një model se ku duhet me mrri edhe të jenë shumë me të përgatitur për tregun, tregun ku ku duhet me qenë me të aftë se tash që jemi.

Drenushë Morina: Sa jemi te arsimit, na tregoni pak për kohën, për periudhën gjatë arsimimit të ju, t'u nisë prej shkollës fillore, cilën shkollë keni ndjeke mësimet, sa ka qenë pjesëmarrja e komunitetit rom?

Osman Osmani: Une shkollim fillor e kom fillu domethënë këtu në Prizren. Kam qenë nxënës i shkollës fillore e cila sot emërtohet si "Lidhja e Prizrenit", në atë kohë u emërtojke si "Mladen Ugarević", kam qenë nxënës i asaj shkollës prej klasës parë deri në tetën. Shkollën e mesme po ashtu e kom kry këtu në Prizren, në Shkollën e Mesme Teknike atëherë u thirrke "Gani Çavderbasha", tash që është "11 Marsi". Kam qenë gjenerata e parë e cila ka qenë me një sistem të ri në '76-tën e cila osht' vendos atëherë në atë kohë me sistemin e arsimit. Edhe mas përfundimit shkollës mesme une domethënë kom qenë një vjet në shërbimin ushtarak edhe vazhdova studimet e mia në Beograd në vitin '81, '82 deri në '84-tën.

Në '84-tën ku përfundova, në '85-tën arrita edhe të punësona në "Printeks". Edhe pse nuk kom pasë naj problem shumë të madh në punësimin tim, sepse unë kam qenë ndërkohë unë pata konkurru për bursë të studentëve që studiojshin në degat profesionale, qajo sipërmarrje përpara i ndajke edhe bursat për atë degë të caktuar. Ashtu që, unë kur konkurova i pata përfitu, i pata ofru arsyetimin se që jom në vitin e dytë, i pata ofru edhe suksesin tim atje që pata mesatarën e mirë edhe kjo më pruni pozitë që unë të përfitojë njëfarë burse edhe me një mënyrë indirekte të jem, mos të them direkt por e kom pasë me një mënyrë sigurume vendin e punës.

Në momentin që një sipërmarrje përpara ta jipke bursat, bursën, ajo me një mënyrë indirekte... në shumicën e rasteve qata që përfitojshin bursën u bojshin pjesë e asaj sipërmarrjes, domethënë edhe u punsojshin në atë sipërmarrje edhe vazhdojshin punën e vet. Unë pata fatin domethënë të përfitoj bursën nga "Printeksi" edhe mas përfundimit, mas diplomimit, kur e mora vërtetimin... bile interesant atëhere diploma u duke me prit edhe nja gjashtë muj m'u botu, une kur u mbyll "Printeks" në 2004-tën edhe kur shkova mi tërhek dokumentet e mia si gjithë punëtorët tjerë, në fascikëll timen, në formularin tim ku jonë konë dokumentet për tjerë ka qenë vetëm vërtetimi. Diploma kurrë s'është lyp diploma jem në sipërmarrje sepse normal me punën, me veprimin, me njohurit që i kom pasë

asnjëherë nuk ka ardhë në dyshim që me thanë, “Bjerna be atë diplomën ta verifikojmë a je ti vërtetë, a ki studiu apo jo”, po vetëm vërtetimi i shkollës që unë kom diplomu.

Diploma hala pa qelë asht’ në rollne aty e mbyllën edhe asnjëherë nuk ka qenë në “Printeks” me pa. Po atje puna, puna të cilën e kam bo, ato që kom pasë fat të punoj, të vazhdoj të punoj me njerëz të cilat i kom njoftë, sepse njerëzit të cilët kanë mbajtur mësimet, landët profesionale në shkollat e mesme me një mënyrë ata kanë qenë direkt kanë qenë kolegët e mi të ardhshëm. Edhe mas përfundimit të studimit, normal ata kur më pavën që u paraqita në “Printeks” edhe u punësova, ka qenë domethënë për ata një kënaqësi që një nxënësi i atyre ka ardh në pozitë që të jetë kolegë atynve. Pak a shumë ata kanë pasë njohuri për kapacitetet e mia edhe mundësitë e mia edhe kom pasë një mbështetje prej atynve, edhe kom vazhdu domethënë, të punoj, të veproj kuadër të një reparti të caktuar.

Fillimisht kom punu në repartin e vektarijës, domethënë në reparti i cili osht’ marr me prodhimin e bezëve, çarshafave, mbulesa për tavolina, ka pasë domethënë një... lloje të gjërë artikujve të cilat janë prodhu në atë repart. Unë pak a shumë kom pasë njohuri sepse dhe gjatë shkollimit mesëm, por edhe gjatë studimeve ashtu u konë sistemi që çdo javë kemi pasë praktikën edhe kemi pasë obligim bile-bile edhe me punu në makina, me provu vetin, me mësu vetin. Në këtë mënyrë që me njohjen e teknologjisë por edhe me çëshjtet tenike direkt në prodhim; të jesh ma i përgatitun edhe m’i dijtë problemet, sfidat me të cilat mund të ballafaqohesh edhe në këtë mënyrë sa ma lehtë t’i zgjidhësh.

Pjesa e Dytë

Osman Osmani: Në fillim e mbaj mend, atëherë kur u vendosa mas kohës praktike unë si inxhinier osht’ deshtë fillimisht të bëj një vjet punën, punën praktike, por udhëheqësit e asaj kohës u duke m’i njoftë edhe duke pa domethënë angazhimin tem ata e panë që mas tëtë muajve, nëse nuk gabo, e nderprevën punën time praktike edhe menjëherë më vendosën në pozitën e udhëheqësit të një repartit. Fillimisht une i kam menaxhu 246 punëtorë që ka qenë një numër goxha serioz, është punu me tri ndërrime edhe ka qenë një punë ku është deshtë edhe të menaxhohet edhe të administrohet. Domethënë edhe komplet procesi i punës prej momentit përgatitjes penit, fijes për vekin deri në momentin kur del bezi i gjysmë përpunuar apo fare i papërpunum, por i gatshëm edhe i përgaditun për fazat e ardhshme.

Kjo në kohë ka pasë mundësi të kalon edhe domethënë një javë, dy javë prej momentit përgatitjen deri në momentin e vekimit e deri te dalja e materialit. Por është deshtë domethënë një kontinuitet edhe një menaxhim shumë të mirë strikt i të gjitha proceset që jonë mrena këtyre proceseve fillestare edhe përfundimtare të menaxhohen, mirëpo mos me ardh deri te shkëputja e atij zinxhirit të punës edhe dalja e procesit të prodhimit. Kom pasë fat, domethënë sikur që thashë, përveç kolegeve edhe punëtorët me të cilët kom punu të jenë mirënjohës apo kuptues, e më kanë kuptu edhe nuk e di me

siguri se edhe njohuritë e mia për shkencën apo teknologjinë për të cilën kam studiju e kanë vërejtë që kam pasë njohuri të mjaftueshme.

Kam zhvillu edhe ndryshime domethënë në proces në teknologji por edhe në nxjerrjen e materialeve, prodhimeve të reja, pse teknologjia e “Printeksit” ka qenë e bazune në prodhimin e materialeve natyrale prej pambukut por edhe prej, përzime domethënë edhe pastër prej sintetikës, prej najlonit, poliestërit, poliamid. Domethënë, varësisht prej kërkesave të tregut çka është kërku janë prodhu edhe ka qenë pozita që... nevoja që të planifikohët me kohë mirë çka do të prodhohet, çka kërkon tregu sa material na vyn, cili material sepse na kemi pasë qenë në situata të palakmueshme. Për shembull, kojshia jonë ka qenë industria e tekstit “Progres”, e cila marojke material poliestër, material sintetik edhe... por në shumicën e rasteve ai material vike jo i cilësisë të lartë.

Për shembull, të njëjtin material e porositshim prej Sllovenijës, pi Lubjanës, ai vike prej shumë të cilësisë ma të lartë, makina nuk dike me u ndal me atë material. Ndërsa, kur vijke i njëjti material me njëjtë, numeracionet e njëjta, vlerat e njëjta sikur i Sllovenisë ky i “Perllonkës” që e dijsim “Progres” ndryshe, Industria e Filamentit Sintetik, kemi pasë shumë probleme, shumë cilësi të dobët. Ka kriju edhe shumë sfida atëhere në prodhimin e e materialit përgaditor, në përgaditje, në procesin e përgaditjes, deri të momenti i vekimit, realizimit të këtij materiali. Po të gjitha këto sfidat ka qenë vërtetë një, një, një, një çështje e cila shpesh m’ka pru në pozitë që a muj, a jom në gjendje ta menaxhoj këtë proces. Po them, falë kolegëve, falë kolegëve por falë edhe punëtorëve kuptimit të atynve une, une jom mundu edhe besoj se kom arrit të jem i gatshëm të menaxhoj njerëz.

Edhe duke ditë se vitet ‘80-ta, në fillimet ‘90-ta veç kanë qenë vitet problematike për për Kosovën, për qytetarët e Prizrenit në atë kohë. Veç ‘91-tën ka qenë koha kur disa prej sipërmarrjeve patën vendos masat e dhunshme, me një mënyrë shteti dojke ti m’u orientu apo me deklaruar a je ti për këtë shtet apo për këtë shtet tjetër. Edhe të bijke me një pozitë palakmueshme, që ti në vend me u marrë me çështjen të cilën ki, ki arsimu edhe je ekspert, u duhke me qenë edhe politikan. Mu si pjesëtarë të komunitetit rom shpesh ka qenë shumë pozitë palakmueshme, sepse punëtorët e mi, punëtorët e “Printeksit” kanë qenë punëtorët edhe komunitetit shiptar, kanë qenë edhe punëtorët e komunitetit boshnjak edhe goran edhe serb, edhe komunitetit rom edhe turk. Domethënë, unë i kom pasë të punësum të gjitha komunitetet.

Normal shumica kanë qenë ata komunitetit shqiptar por në atë kohë sistemin e menaxhojshin pjesëtarët e komunitetit serb edhe vërtetë ka qenë nje sfidë e madhe. Kjo edhe sot e thom që është një problem goxha i theksur për mu, sepse ka qenë vërtetë problem me menaxhu me popullatën, me njerëzit e thjeshtë, me punëtorët e thjeshtë e cila vetëm që i përkasin etnive të ndryshme, qeverisjeve të atëhershme krijojshin probleme. Domethënë, thjeshtë kanë qenë çështjet politike të cilat kanë dirigu vijimin apo punën e matutjeshëm. Edhe kjo më ka kriju edhe shumë një sfida të madhe, patën fillu edhe grevat, patën fillu ndërprerjet e punës që mu kur në atë kohë kur kam qenë në pozitë të mesme të menaxhimit të niveleve të reparteve. Kam qenë domethënë me një mënyrë si ai top

ndërmjet dy zjarreve, sepse në një mënyrë ti osht' deshtë të organizosh punën tande, të organizosh prodhimin në anën tjetër, punëtorët tregofshin pakënaqësisjen e vet.

U mendojsha domethënë mos t'i bi në pozitë që të jenë viktima të veprimeve politike, sepse ka qenë me një kohë kur për fat të keq najherë shumica e punëtove kanë... janë largu prej punës vetëm për shkak se najherë ka deklaruar ndryshe ose ka mendu edhe ndryshe nga qeveria e atëhershme. Vërtetë une i kam njoftë, edhe i njoh shumë ekspertë të ndryshëm të cilët thjeshtë e kanë hup vendin e punës atëherë, pa e pasë mundësinë me siguri ekzistencën e familjes vet vetëm se ka qenë i komunitetit tjetër apo ka qenë, me një mendim pak ndryshe se ajo që është preferu prej prej shtetit. '99-ta ka qenë atëhere një... ka pak sfide më e madhe e problemeve kur domethënë shumica e njerëzve osht' deshtë të largohen nga puna, osht' deshtë të largohen edhe prej shtëpive të vet, në anën tjetër osht' deshtë të organizohet pak a shumë edhe puna, të organizohet i edhe prodhimi. Por, normal, në ato kushte prodhimi nuk ka ekzistuar edhe aq.

Me përfundimin e '99-ës, domethënë ka vazhdu "Printeksi" të punon, të mbledh punëtorë, të mbledh gjithë ata që i kanë pasë njohurit e ndryshme për nivelet e ndryshme të organizimit të punës. Por nuk e di më doket se UMNİK-u i atëhershëm thjeshtë e ka pasë... Njëra prej obligimeve të atynve ashtu une e kom ndjenjën ka ardhë me një detyrë që të shkatërron të gjitha ato sipërmarrjet të cilat njerëzit kanë investu, është nda prej gojës, jonë marrë kredita të shtrenjta. Unë e di shumë sipërmarrje, shumë pjesë të "Printeksit" të cilat ka pasë makina të cilat as nuk janë hap, kanë qenë ende të mbyllura, të konzervuara, nuk i ka pasë ardhë rendi për me u hap edhe të vendoset në interes të prodhimit në rritjes së prodhimit, rritjes të cilësisë së prodhimit, edhe shpejtësisë. Edhe në fund thjeshtë ka qenë interesi më duket i UMNİK-ut dhe me siguri se edhe qeverisë edhe ka pasë, është deshtë të ketë njohuri për këto procese.

Këto sipërmarrjet e mëdhaja apo organizatat e mëdhaja të cilat kanë siguri ekzistencë 2000, 3000 familjeve, në fund të ngelin pa kafshatë të bukës. Paradoksi ma i madh ka qenë kur masi është privatizuar "Printeksi" osht' folë se... kom pasë dëgju që në bazë të njohurive të mia "Printeksi" e ka pasë edhe një repart në Reçan, ka pasë edhe një repart në... afër Zhurit, afër fshatit Shkozë. Bile, aty kalon, përmi ato edhe autobani ka qenë një hapësirë prej disa hektereve aty, plus një hapësirë goxha e madhe këtu në Reçan, ku është tash sipërmarrja e "Fruti", plus "Printeksi" i cili i ka pasë me hektera tokë në fund është shit vetëm për tre milionë e gjysë euro, që është shumë një paradoks i madh. Vetëm toka t'ish shit, kish vlejti shumë ma tepër shumë milionëshe e jo tre milionë e gjysë.

Plus, në bazë njohurive, asnjëherë nuk është tentu së paku "Printeksi" i ka pasë disa kapacitete, mos të them shumë të përparume, por thjeshtë që osht' mujt të organizohet njëfarë prodhimi, të sigurohet njëfarë ekzistence i disa familjeve. Mos të them një mijëshit, dy mijëshit jo me siguri, por të një numrit, për shembull njëqind familjeve, 200 familjeve të sigurohet njëfarë eksistence, njëfarë prodhimi edhe të vazhdohet të punohet ma tutje. Por nuk ka pasë asnjë tentativë as prej ktyneve që i kanë privatizuar,

domethënë edhe prej ktynve që i kanë privatizu, po edhe pi ktynve që e kanë ble “Printeksin” komplet. Thjesht tash jemi dëshmitarë që osht’ bo si një qendër tregtare.

Por nuk e di, nuk po muj me kuptu najherë. I kom 56 vjet, nuk po muj me kuptu ku mujnë me gjetë gjithë atë tregti pa pasë najkush me prodhu, me punu, me fitu e me shku me ble. Sipërmarrje shumë pak, sipërmarrje shumë pak, disa qendra tregtare sa të dush në anën tjetër, kur pi shoh qendrat tregtare plot, plot njerëz tash ka po vijnë ato mjete, ka i kanë mundësit njerëz me siguru ekzistencën e vet me siguri se edhe diaspora në këtë drejtim po na ndihmon, se i ndihmon ata edhe bizneset me të cilat mirren. Por thjeshtë kur po bisedojsh me të rinjtë, shumë pak janë ata që e shohin një perspektivë të mirë, një perspektivë të fortë në këtë drejtim. Thjeshtë jemi dëshmitarë që shumë njerëz, shumë të rinjë po na largohen prej ktuhit, qoftë në mënyrë të martesave me vajzat tona apo me djemtë tonë jashtë, veç me gjetë mënyrën mu largu.

Po i kryejnë studimet, domethënë po investon familja në to, po investon shteti në to, në fund e ka një përvojë të vogël edhe në fund po përfundon diku në perëndim. Po i lanë enët apo me naj *baushtell* [gjermanisht - ndërtime] po punon për me fitu ekzistencën, për me siguru ekzistencën për veti dhe për familje. Kush po jetë këtu? Po jesis na që pak a shumë kemi dhanë njëfarë kontributi, na po presim që ju të rinjtë të vazhdoni në këtë drejtim edhe është një mesazh tepër negativ që po i dërgojmë të rinjve. Këto për fat të keq që unë në këtë moshë po duhet me ju dërgu juve, po në të vërtetë shumë pak po bohet që të bohet ndryshimi, të bohet një ndryshim cilësor, të bohet një ndryshim rrënjësor.

Nuk kemi nevojë me mashtru tjetër konë, nuk kemi nevojë me rrejt tjetër konë, thjeshtë duhet pak ma mirë me u organizu. Duhet t’i ndryshojmë mendimet, duhet të rive të cilët kanë studiu, kanë kry kanë provu pak a shumë t’i jipet mundësia të menaxhojnë, të jenë pjesë e vendimmarrjes edhe të përmisohet pozita në këtë drejtim. Mu po më vjen keq që për shembull djali jem osht’ jashtë, prej... osht’ i gjashti vit, është i martum i ka dy fëmijë, fëmija i dytë i ka lindë si... me shtetësi gjermane edhe tash mo faktikisht atina mas një kohë të shkurt mo nuk i vjen rendi me mendu për Kosovën apo për Ballkanin apo për prindërit apo për vazhdimin e bashkëjetesës këtu, e ka bo njëfarë rendi atje. Vajza e dytë e cila po diplomon edhe ajo ka me më shku, me konë ka me metë une? Une i kom pasë prindërit, i kom kqyrë deri në ditën e fundit, kush mu ka me më kqyrë?

E kjo po na pret të gjithëve neve që jemi këto moshat 50, 60 vjeçare, nëse të rinjtë fillojnë të mendojnë vetëm për me dalë jashtë. Për fat të keq, duhet me i kriju mundësitë të rinjtë të përfitojnë njëfarë perspektive, njëfarë sigurie, njëfarë perspektivë që ka mundësi këtu me jetu, ka mundësi këtu me ndryshu, vlen këtu me jetu, vlen këtu me vazhdu jetën tande edhe veprimin tand. Po për fat të keq, jo te komuniteti rom. Unë po flas të në përgjithësi sepse kom rast të bisedoj me shumë të rinjë, me shumë njerëz të komuniteteve të ndryshme, edhe te shumica e të rinjve po i ndëgjoj këto fjalët që mu po më krijojnë një brengje edhe një... ka po shkojmë, ka jemi t’u shku?

Une kom pasë dëgju një filozofi apo një fjalim, një një tregim që me ardhjen e ndërkombëtareve çështja e arsimit edhe çështja e shëndetësisë pak a shumë shkatërrohen. Përnime, na jemi vetë dëshmitarë që këtë problem e kemi. S'ka ditë që po kalon edhe nuk kritikohet sistemi i arsimit, s'ka ditë që kritikohet sistemi i shëndetësisë edhe pse pse na jemi një milion e 700 mijë njerëz këtu. Shumë qytete e kryeqytetet botërore i kanë shumë ma tepër milionëshe edhe kanë një sistem të mirë të organizimit të brendshëm. Pse këtu na një milion e 700 mijë njerëz, nuk mujm me qenë, me pasë sistem? Najkujt s'po i konvenon, najkujt, kjo pra po parashtrahet pyetja, najkujt pra s'pi konvenon, pra s'pi konvenojka ktu me pasë rend, mu konë në rend. Na nuk presim këtu me honger me luge të arit e s'di çka, po njëfarë rend që këta të rinjtë vërtetë po angazhohesh te ata, po angazhohesh për arsimimin e atyne, po angazhohesh, po ai të ketë edhe mundësi diku edhe të sigurohet një ekzistencë e atyne.

Normal që ekzistenca nuk mund të presim që te na siguron sipërmarrjen, shteti mo nuk e përkrah sistemin socialist. Hapja e sipërmarrjeve të mëdhaja, punësimi i një mijë, dy mijë njerëzve, por shteti ka mundësi të planifikon mekanizma të ndryshme e cilat, të cilat i lehtësojnë investimet edhe hapjet e vendeve të reja për 50, 100 vend, 200 vend edhe kapak - kapak të ndihet domethënë ajo ndryshimi. Të rinjtë duhet ta kuptojnë ndryshimin, të rinjtë duhet ta ndijnë ndryshimin, për me qenë të sigurt që këtu paska mundësi me vazhdu me ekzistu. Kjo është shumë problem, kjo është shumë problem edhe kjo është një sfidë të cilën jo vetëm që i takon qeverisë edhe ne, moshatarët mi 50-60 vjeçarë të cilët kanë vepru edhe punojnë në këtë drejtim. Duhet të [mendohet] qysh me punu, qysh me ba ndryshim, qysh një vend prej një milionë e 700 mijë njerëzve me pasë njëfarë rendi, qysh këta të rinjtë me u ndi të kënaqur, mirë edhe me një perspektivë pak ma të mirë se qetash që kanë.

Jo ideale sepse edhe për ato vyen kohë, për çdo ndryshim vyen kohë, për çdo ndryshim... ajo është një revolucion, çdo punë është një revolucion edhe kur të bëhet revolucion, i vyn kohë. I vyn kohë për ta kuptuar deri te ai i fundit. Por hajde ata të parët, të dytë ta kuptojnë sa ma shpejtë edhe të jenë të gatshëm sa ma lehtë t'i përcjellin atynve që jonë mas një... ekziston e mira mund të arrihet e mira edhe kjo është ajo rruga që mundet... jo vetëm të dalim me deklarata, "Do të bohët mirë, do të bohët mirë", nuk ka kurgjo prej asaj. Po thom, une e përmenda, më doket që UNMIK-u ka ardhë me këtë qëllim me na i mbyll sipërmarrjet, me na shly prej memories socializmin apo... mu nuk mundet me ma shly memorien sepse une kom lindë, kom jetu edhe jom rritë në atë kohë edhe kom arritë gjitha këto që i kom falë asaj kohës.

Nuk mundet kërkush me më bind se ajo ka qenë kohë e gabume, nuk mundet sepse i takoj komunitetit tim, edhe une nivelin që e kom arrit, e kom arrit falë asaj kohës edhe veprimeve edhe edukimit i kom pas në atë kohë. Qoftë edhe prej familjes, qoftë edhe prej shoqërisë, kjo është ajo që duhet ta vlerësojmë, duhet ta dimë edhe të reflektohet edhe në jetat e gjithëve tjerëve. Nuk e di besoj se mjaft argumente kom dhonë pse jom i intersum me qenë pjesë e kësaj shoqërie, kam qenë pjesë e kësaj shoqërie, jom i interesum me dhonë ndryshime sidomos për komunitetin rom, sepse nëse ai përmirësohet, pozita e këtij komuniteti në shoqëri, pozita sociale, arsimore, punësimi, shëndetësisë, normal që brenga e shtetit në rend të parë ka me qenë ma ulët në krahasim me të kaluarën. Nëse

vazhdohet të jetë një popull i paarsimum, vazhdon të jetë populli me probleme të theksime, normal që ato probleme do të jenë pjesë e shtetit sepse ajo duhet me u marr me këto probleme, ajo duhet me ofru ndihmë, ajo duhet me kriju mekanizma për me ndryshu, tri pika.

Drenushë Morina: Përmendët që pas përfundimit shkollës së mesme keni vazhdu një vit në shërbimin ushtarak, nëse keni ndonjë kujtim të veçantë që mundeni me përshkru gjatë asaj kohë?

Osman Osmani: Une në atë kohë kam qenë... sepse para me shku ushtar osht' deshtë të shkojsh në Nish, u bojke vlerësimi domethënë për cilën degë të ushtrijës je, ki njohuri apo ki aftësi. Mu më patën vendos për lidhje, edhe lidhje... sepse atëherë në atë kohë kanë qenë lidhjet foniste edhe lidhjet telegrafiste edhe une kam qenë telegrafist. Domethonë e kom pasë gjashtë muajt e para e u pata aftësu për Abecedën e Morseut¹ edhe dërgimin e porosive nëpërmjet telegrafisti, telegrafisë. Bile pata kalu, arritë nivelin e dytë të shpejtësisjës, sepse diku nga përfundimi i përgatitjes patën dalë edhe qato mekanizmat elektronike që e rritke edhe shpejtësinë e dërgimit të signaleve apo edhe këtyne gërmave. Ka qenë vërtetë një një kohë për mu e cila vërtetë ka qenë një kënaqësi e madhe, sepse në atë kohë ende ka qenë Jugosllavia, kanë qenë të rinjtë prej të gjitha vendeve të ish-Jugosllavisë.

Tash jo që kam qenë i komunitetit rom, por vetë pjesa që unë kam qenë me një mënyrë pjesë e Kosovës edhe i kanë ditë disa traditat e Kosovës nuk kanë guxu as me na shajhtë, nuk kanë guxu as me na ofendu, edhe pse ata nër veti, njoni-tjetrin e shajshin si mirëdita i thojshin vetit. Por e dishin që na nuk i durojmë këto sende edhe kemi pasë një respekt shumë të veçantë. Kjo që p'e tregoj asht' në kohën '80, '81 kur kam qenë une ushtar. Domethënë, kam qenë në Mitrovicën e Sremit e masanej një kohë në Suboticë kam qenë atje gjashtë muj atëherë apat kom vazhdu gjashtë mujt e ardhshme apat në Mitrovicë domethënë të Sremit.

Kom qenë pjesë e xhimit të disa filmave atëherë në atë kohë, u xhijojshin shumë filma edhe ushtrijën e mirrshin atëherë si statista plotë. Kam qenë pesë herë pjesë e ushtrimeve të mëdhaja, sepse për shembull një një kolonel i cili dojke me kalu në pozitën e gjeneralit, ai u konë i obligum me organizu një luftim në thonjëza edhe domethënë gjithë ato lidhje, gjithë ato sendet osht' deshtë të, të... ato mekanizmat të jenë përcjellëse edhe t'i zhvillojnë për mos me pasë... për me arritë domethënë që ai ka diplomu edhe ka arritë. Une kom qenë pesë herë në ato ushtrime edhe për çdo ushtrim unë i kam pasë ka shtatë ditë shpërblim, po ka shtatë ditë shpërblim edhe çdo herë kom ardhë të shpija edhe i kom shfrytëzu bile edhe për këto kam qenë edhe si ushtar i dallum.

Kemi pasë shoqni bile para ja dy vite mu pat lajmru njoni ai ka qenë i Kroacijës. Më doket se ka qenë i Zarës edhe ku me ditë qysh më ka pasë gjetë me emër më ka pasë majtë në mend mas 30-35 vjet edhe më pat shkrujt. Ai ish t'u vazhdu t'u jetu në Kroaci, në Zarë edhe e kish majtë në mend, domethënë emrin edhe ma ka gjetë në Facebook edhe kemi... më veti a jom qajo gjenerata që kemi qenë bashkë

¹ Alfabet ose kod në të cilin shkronjat përfaqësohen nga kombinime të sinjaleve të gjata dhe të shkurtra të dritës ose tingullit.

në filon kohë ushtar edhe pak e shumë në Facebook i përkujtum atë kohën kur kemi qenë bashkë me ato edhe ka qenë një kohë jo që i mirrshe njëfarë njohurie, por krijoshe njëfarë shoqërie të mirë, bon vaki ka qenë në thonjëza, une në jetë e kom përjetu vërtetë ato, kom pasë një shoqni shumë të gjonë, kemi kalu shumë mirë edhe nuk ka shancë të kthehet mo ajo.

Drenushë Morina: Na tregutë që sot punoni si drejtor në një organizatë joqeveritare. Na tregoni pak rreth punës, rreth misionit të organizatës, dhe sa keni nostalgji për punën që e keni ba në “Printeks”?

Osman Osmani: Vërtetë këtu në këtë kohë e kom pasë një sfidë goxha të madhe kur... kur është deshtë të filloj diçka të punoj ndryshe prej asaj që kam punu deri në atë moment. Inxhinierët në përgjithësi njihen si njerëz që nuk flasin shumë, inxhinierët e kanë lapsin, e dinë llogaritjen, e dinë sa duhet me fillu e sa duhet me mbaru edhe duke i bo njëfarë koordinim të dhëmbëzorëve, të shpejtësisë, të kohës, të temperaturës e dinë se kur do të fillon, e kur do të mbraron edhe kur osht’ deshtë të planifikoj diçka ndryshe. M’u ka pasë ofru mundësia domethënë të jem pjesë e shoqërisë civile edhe të provoj të jap kontributin tem në pjesë të organizatave jo-qeveritare edhe kur, në fillim kur m’u ka dhonë hapësirë kom mendu se çka osht’ ajo që duhet, muj me dhanë ose ma s’pari do të ndihna mirë, rahat me vetveten, por edhe do të mundona të vazhdoj domethënë të kem sukses edhe e vëreja që arsimimi është ajo çështje me të cilën duhet të mirrna.

Edhe kjo ka qenë njona prej temave, fokusit që... në të cilën une duhet të organizona edhe të angazhona edhe gjithë ata njerëz me të cilët punoj, veproj domethënë kanë me pasë këtë detyrë, detyrën e arsimimit të fëmijëve rom. Në fillim ka qenë vërtetë ato problem që e thashë, sepse mas pari është deshtë me çelë gojën, unë e kom pasë problem me e çelë gojën por... sepse problemi në shoqëri civile përcillet vetëm duke i tregu, duke i sqaru edhe duke ndiku nëpërmjet fjalës të mirë, të urtë, najherë të keqe, kritikuese. Domethënë, najherë varësisht prej momentit, por është deshtë të jesh shumë ma i përgatitun për me folë. Duke bashkëpunu me shumë njerëz, duke bashkëpunu me kolegë në shoqëri civile, me organizata, duke përdorë raporte të ndryshme që jonë prodhu në atë kohë për komunitetin, për shoqërijën tonë, për qytetarët. Domethënë, pak e shumë këta më kanë ndihmu edhe ta krijoj domethënë njëfarë plani, fokusi ku do të orientona, ku do të punoj edhe mënyrën si do të veproj.

Ma tutje veprimet të cilat i kemi marr edhe rezultatet e para por edhe sfidat me të cilat jemi ballafaqu domethënë thjesht më kanë kriju temë... temë të mjaftueshme, fjalor të mjaftueshëm për me arsyetu komplet këtë procesin, këtë temë me të cilën jam marrë. Problemi... problemi të cilat në fillim ka qenë që thjesht une duke pasë njohuri për një tekstil, për një teknologji është deshtë me kalu krejtësisht fazë tjetër, është deshtë të menaxhoj një organizatë, por është deshtë pak e shumë tash me pasë njohuri pak edhe ma të ngritur përveç menaxhimit të njerëzve, proçeseve është deshtë edhe administrimin e organizatës, administrimin e financave, kontabiliteti. Domethënë, shumë, shumë, shumë procese të ndryshme të cilat pak e shumë nuk kemi pasë njohuri, nuk kemi pasë njohuri çka osht’ projekti, nuk kemi pasë njohuri qysh hartohet projekti, qysh menaxhohet projekti, çka osht’ qëllimi, çka jonë

objektivat, qysh t'i lidhim këta segmentet me aktivitete me rezultate të pritshme, cilat janë sfidat paraprakisht ti me ditë se me çka do të ballafaqohesh, qysh do t'i tejkalosh.

Plus proceset përcjellëse avokime, lobime, dukuritë negative cilat janë, çka duhet me vepru kundra atynve, gjitha këto në fillim, domethënë për fat të mirë qysh me donatorët e ndryshëm kanë vepru edhe na kanë ofru mundësinë qysh të na informojnë, të na mësojnë, edhe duke provu me hartu projekte edhe me na leju projekte të vogla, të mësohemi me implementimin, me hartimin e këtyne projekteve. Pra edhe në implementimin e këtyne projekteve në përgjithësi që si rezultat i japin çështjet e caktuara të suksesshme. Misioni i organizatës ka qenë, domethënë është në përgjithësi që të arrijmë një integrim të plotë të komunitetit rom në shoqëri civile, në kuptimin e arsimit edhe në kuptimin e mirëqënies sociale... mirëqënies të atij në të gjitha fushat punësim, shëndetësi, mirëqenie, domethënë të gjitha fushat të cilat janë në interes të komunitetit edhe në jemi të vetëdijshëm se jemi nismëtarë të mirë, kemi qëllime të mira, kemi stafe të mira, stafin e mirë, kemi grupin e njerëzve, studentëve, mbështetësve të këtij procesit edhe une muj me thonë që kjo osht' nisma, kjo osht' fillimi.

Shpesh i kom thonë këtë fjalën edhe donatorëve të ndryshëm, une jom si ai blegtari që e gjunë farën, tash për moment jom t'u gjujt farën, toka osht' përpunu domethënë ka shumë njerëz që kanë kalu fazën e projekteve, fazën e hartimit të projekteve, fazën e menaxhimit të projekteve, donacionet çka janë donacionet, qysh shpenzohen donacionet, rregullat ligjore. E tash jom në këtë moment që jom t'u gjujt farën, na po presim që ata punë, aktivitetet që kanë të bëjnë me arsimimin domethënë të japin rezultat. Jo tash të flasim për njëqind studentë, tash të flasim për 200, 300, 500 studentë të cilët i kemi në Komunën e Prizrenit. Të flasim jo për 30 a 40 studentë të diplomum, por të flasim për njëqind, 150 studentë të diplomum. Eh, atëherë veç mund të flasim për një ndryshim vërtetë cilësor edhe për një mundësi ndryshe të planifikimit

Normal se edhe aty jesis shumë sfida me të cilat duhet të veprohet, punësimi i atynve, hapësira e krijimit e punësimit, hapësirës atynve, po kjo do të jetë atëherë një veprim për gjeneratat e ardhshme. Thjesht une besoj se me kolegët e mi, me shokët e mi, me moshatarët e mi edhe me këta ma të rinjtë po edhe me këta ma të vjetër vërtetë kemi lëvizë shumë sende edhe kemi kriju një hapësirë pozitive në këtë drejtim. Sado të arrijm sukses ,ajo krejt varet prej komunitetit, varet prej ligjeve, varet prej qeverisë lokale, qendrore, varet prej politikave, varet prej ligjeve, varet prej hapësirës, varet prej donacioneve, por kryesore varet prej komunitetit. Nëse komuniteti nuk e bind vetin se ka nevojë të ndryshoj rezultatet kanë me mu... nëse ai e bind vetin që ka nevoj të ndryshon, ai do t'a arrin ndryshimin.

Une tash shpejtë e kem pasë një intervistë me një grup, më doket që kanë prej Gjermanies edhe më vetën, më bonen një krahasim më tha, "Kur je konë ti në shkollë fillore, të mesme, a je konë atëherë në pozitë ma të mirë ekonomike, sociale a qetash?" "Jo", i thashë, "atëherë kom qenë shumë ma fukara se qetash". Normal qetash që ka ndiku se shumë sene p'i blejsh shumë ma lirë. Atëherë nuk ki pasë mundësi, une kur jom konë në moshë... moshatar ma i ri se ti. Atëherë ka qenë shumë punë e madhe

me pasë patikat e Kinës i thojshin “Najke”, atëherë në atë kohë. Këto po e tregoj në vitët ‘70-ta edhe kanë qenë shumë shtrenjtë, edhe i kemi rujt si sytë e tona, edhe i kemi bajt ka tri-katër vjetë. Ndërsa fëmija jeme nuk shkon me ato tjera, ai ban patikat ka një muj, dy, tre, patikat i blen ka 100, 200 evro, ku jem, çka jem? Osh t’ domethënë njëfarë dallimi që osh t’ ndryshe nga e kaluara, por edhe pse kom qenë shumë ma fukara në atë kohë, kemi jetuar mirë... kemi jetuar mirë edhe jemi të kënaqur me këto.

Pjesa e Tretë

Drenushë Morina: Po vazhdoj me një pyetje që zakonisht bohet në fillim po unë e lash për në fund. Jeni po ashtu një prej njëzëve të rrallë ndoshta që e keni edhe emrin e njëjtë si mbiemrin nëse mundeni me na tregu një histori të shkurtër të kësaj pse jeni, pse ju kanë emëru me emrin e njëjtë si të mbiemrit edhe kush ju ka lanë emrin?

Osman Osmani: Aha jo, kjo (qesh) osh t’ pak histori ma e gjatë une, mbiemni, emri jem lidhet me babgjyshin tem, me babën e babës tem. Emri i atij ka qenë Osman edhe baba jem prej tre vllaznive ka qenë ma i vogli edhe atina i ka ra hisja që emrin e babës vetë ta përtërinë tek djali vet. Domethënë, une kom qenë një djalë i cili kom lind edhe e kom pasë emrin e babgjyshit jom t’u bajtë. Ndërsa mbiemrin na e kemi prej kohës të babgjyshit tem, ai ka qenë pjesë e një familjes tjetër. Na jemi ende familje, jemi kushërinë me ata, po me siguri se vëllazënitë dishka për shkak interesave të veta të brendshme ka kërku thjesht me ndryshu mbiemrin e vet. Ma herët familja jem osh t’ emërtu si Veçkollar, një pjesë e bukur e kësaj familjes ende vazhdojnë të jessin me mbiemër Veçkollar. Por babë gjyshi jem nuk e di pse, nuk kom arsyetim prej babës tem ka kërku domethënë të ndryshon edhe në atë kohë nuk e di pse ai ka vendos familja jonë të emërtohet me mbiemrin Osmani.

Ashtu që, thjesht pse jom Osman Osmani, Osmani jam për shkak se babgjyshi e ka pasë e mbiemrin. Babgjyshi jem e ka ndryshu, nuk ka dashtë domethënë të jetë i njëjtë si familjarët e atina, të cilat e kanë pasë mbiemrin Veçkollar, osh t’ një mbiemër goxha i vjetër, jonë mbiemër që e kanë pasë para të them... të cilët e kanë pasë dikun para 60-70 viteve, gjashtë vllazën e kanë pasë kjo... jo ma tepër i bjen se para Luftës se Dytë Botërore thonë, baba më tregojke që familjarët, babgjyshi i vet domethënë katragjyshi jem osh t’ me prejardhje, jonë nga Shqipëria. Dikund stërgjyshi jem Bislimi edhe familjarët tjerët, domethënë kushërinjtë e vet, vëllazënitë e vet për shkak kushteve ekonomike, sepse në atë kohë ata jonë marrë edhe me muzikë, por jonë marrë ma tepër edhe me farkëtari edhe nuk ka pasë punë në atë pjesë ku kanë jetu edhe kanë kalu këtu në regjionin e Prizrenit.

Në fillim ata janë vendos në fshatin Leskovec domethënë prej fshatit Leskovec, ku osh t’ sot shkolla filllore domethënë ku këta kanë jetu, kanë pasë shtëpinë e vet, prej aty kanë kalu në Zym të Opojës, jo në Zym të Hasit po në Zym të Opojës. Mas një kohë vëllaznit kanë vendos të ndahen edhe stërgjyshi jem Bislimi ka kalu të jeton në pjesën e Gorës, në fshatin Mlik, dy vllazën të këtyneve kanë vazhdu të jetojnë në Tetovë, një vëlla ka vazhdu me jeton në Prizren domethënë ai qysh para 70, 80 viteve ka kalu

në Prizren të jeton. Një vëlla ka vazhdu të jeton në Blaq në Opojë, ndërsa një vëlla ma i vogli më doket se është kthi në Shqipëri.

Në '95-tën kur u patën hap kufijtë me Shqipërijën, atëherë një kushëri, djali i këtij kushërinut pat ardhë këtu në Prizren edhe në bazë të emrave që i ka ditë prej pleqve na pat gjetë. Mu nuk më njifshin, po e njifshin babën tem. Atëherë baba e pat pru edhe atëherë u patën njoftu edhe atë pjesën e familjes e cila ka jetu në Kukës. Edhe pse ai tri vëllazën, njeni një vëlla i pat jetu në Shkodër, njeni në Tiranë, njeni në Kukës, unë i njifsha vetëm këto të Kukësit këta të tjeret nuk e kom njift... njohtë, këta tjerët kemi pasë kontakte, na hijmë e dalim, e respektojmë njeni-tjetrin si familje, po thjesht mbiemrin ka qenë ndryshim prej fillimit edhe ka vazhdu domethënë ashtu ka ngel.

Sa e kom pasë përparësi, kom pasë pengesa, probleme për shkak të këtij emri, mbiemrit, mund të them që në kuadër të familjes time unë e kom pasë një... njëfarë privilegji pse i kom mbajtë emrin e babgjyshit. Domethënë në një mënyrë kam qenë i mbrojtur prej këtyre tjerëve edhe për çështje të tjera të ndryshme, domethënë kur osht' deshtë diçka të jipet, të ndahet nuk e di diçka mirë, normal që Osmani ka pasë përparësi në krahasim me këta fëmijët e tjerë, sepse e ka mbajtë emrin e babgjyshit. Por kjo ka pasë edhe ato pjesët negative, domethënë Osmani osht' deshtë të ruhet ma tepër, mos të dali, të dalë shumë jashtë, mos të ketë shumë shoqëri, sepse Osmanin duhet me rujt e kësi sene.

Por në përgjithësi, une në jetën time kam qenë i kënaqun, jam i kënaqun, kam pasë rast të kaloj shumë momente të mira edhe të jetoj mirë, të jetoj shëndoshë, të jem me familjen time, të jem në pozitë të krijoj familjen e re, fëmijët e mi të cilat kanë vazhdu. Domethënë, të punojnë, të jetojnë edhe ata të krijojnë familjet e veta, të arsimohen, të punojnë edhe të kenë të them në thonjëza jetë normale, sepse fjalë normale osht' çështje relative, çka osht' normale, për dikon osht' diçka tjetër normale, për në osht' normale tjetër, për najkon tjetër osht' diçka tjetër, për ato osht' për të gjithë qysh e shohin vetin. Qysh e ndien kënaqësinë e jetës osht' për ato osht' jetë normale.

Drenushë Morina: Faleminderit shumë, tash nëse keni ju diçka që e cilësoni se duhet me tregu para tjerëve dhe që nuk të kemi pyt mundeni me thanë.

Osman Osmani: Nuk e di, une jom mundu me i përfshi të gjitha ato çështjet të cilat i kom kalu, me siguri qe ka momente të caktuara të cilat i kom kalu. Nëse kur të mbyllet kamera mbijnë në mend bon vaki ju thirri. Po shpresoj se osht' ajo që e kam kam potencu edhe po e potencoj osht' shumë rëndësishme mbështetja e prindërve, mbështetja e të rinjve, të arsimohen edhe të krijohen mundësitë të jemi të barabartë vet të të luftojmë për të drejtat tona edhe për punën tonë edhe për mirëqenien e familjes tonë edhe ndryshmit të cilat na bijnë deri te një pozitë ma e lakmueshme.

Drenushë Morina: Atëherë pas përfundimit ushtarak thatë që keni vazhdu studimet në Beograd, na tregoni pak rreth kësaj periudhe, gjatë cilave vite keni studiju?

Osman Osmani: Në Beograd kam qenë prej vitit domethanë '82 deri në vitin '84, po me diplomim '85, studimet e mia unë kom pasë regjistru Shkollën e Lartë të Tekstilit e cila i ka pasë pesë semestra edhe osht' deshtë edhe një semestër atëherë domethënë ta shfrytëzoj, ta harxhoj për përgatitjen e punës diplomës. Ashtu që, tri vite unë kam qëndru në Beograd në Shkollën e Lartë të Tekstilit, e cila mas përfundimit shkollimit e kom pasë vërejtë që vlerësohet shumë lartë edhe prej kolegëve edhe prej universiteteve të ndryshme, sepse shkollimet e ngjashme kanë qenë edhe në Leskovc, kanë pasë edhe në Zagreb, Duga Resë, ka pasë edhe në Shkup, ka pasë edhe në Lublanë. Por, kapacitetet të cilat i përfitojëshe, njohuritë të cilat i përfitojshe në ketë shkollë të lartë kanë qenë shumë ma të larta, shumë me të avancume në krahasim me këto tjerat që i përmenda, sepse gjatë studimeve pata vërejtë që gjithë profesorët e mi kanë qenë më nivel [të lartë], ma i ulët ka qenë magjistër i shkencave të tekstilit. Ndërsa ka pasë edhe doktora të shkencave në atë kohë.

Bile, njoni prej profesorëve i cili majke ligjërata, këto po tregoj në vitin '83, me ato kemi pasë ka shtatë, tetë ore në ditë, ai majke teknologjijën e thurjes. Domethënë, prodhimin e maicave, prodhimin e veshmbathjeve të brendshme, të xhemperave, ai pat doktoru në Amerikë. Edhe në atë kohë në '83-tën ai kur vijke, përveç tjerash, me na ligjëru edhe me na spjegu procedurën e teknologjinë e thurjes i bijke me veti një ekran të vogël edhe një kasetofon të vogël, për me na tregu se edhe në tastaturë a din... edhe atëherë në dhezke na tregojke sistemin e dosit apo urdhnave thjeshtë që... me të cilat informatika veç pat bërë hapat e para në jetën e njerëzve. Edhe ishim goxha të ri edhe nuk i besojshim, na u dukshin shumë të thjeshta në '83-tën. Shka o ky ekran i televizijës edhe këto... kjo tastaturë?

Në kasetofon ku e qitke një kasetë me programin e caktum edhe i jipke disa urdhna të cilat u realizojshin në ekran, ai na spjegojke se... që na të rinjtë duhet të kemi vëmendje të veçantë sepse kjo osht' e ardhmja. Ai viteve '80-a, viteve '70-a ka diplomu, ka doktoru, domethënë teknologjinë e thurjes në Amerikë edhe pat marrë njohuri që e ardhmja osht' informatika e teknologjia informatike, kompjuterët. Me blerjen e parë të kompjuterit në "Printeks" kur u punësum, unë kam qenë pjesë edhe e grupit për përgatitjen e dokumenteve të brendshme për standardet insonomi. "Printeksi" i viteve '87- '88 osht'... pat kriju një grup i cili kish pjesë, në cilën pjesë mora edhe une.

Që atëherë domethënë menaxhmenti i strukturave menaxhuese e organizatës ka qenë e interesume që prodhimet e "Printeksit" të jenë ma të pranueshëm në botën edhe ne si institucion, si organizatë, si industri osht' deshtë domethënë të jemi të çertifikum me me standartet ISO² dhe në këtë mënyrë që të konfirmojmë që gjitha ato prodhimet që vazhdojmë t'i prodhojmë në "Printeks", i përmbushin standartet jo vetëm Jugosllavijës por gjithë botës. Domethënë, aty ku plasohet malli i "Printeksit". Une për nja dy vjetë pata marrë pjesë në grupin për hartimin e këtyre dokumentacionit të brendshëm edhe proceseve të cilët kanë të bëjnë me ISO standard... njohuri, po atëherë na u pat ble edhe kompjuteri i parë në "Printeks" edhe atëherë edhe veç patën fillu programet e *Word-it*, *Excel-it*

² Organizata Ndërkombëtare për Standardizim, e njohur gjerësisht si ISO, është një organizatë ndërkombëtare për standardet i përberë prej organizmave te ndryshëm kombëtare të standardizimit.

domethënë qëto kanë qenë kom pasë rast edhe të jem edhe atyne kurseve fillestare “Doc” programeve që u thirrshin, ku duke çdo send për me urdhnu.

Deri në momentin kur ‘88-tën, ‘89-tën u ble kompjuteri me Windows e gjitha ato programet brenda të cilat nuk kem pasë mo nevoj me i urdhnu edhe për me arritë një qëllimi të caktuar. Thjesht me një klikim në ikonat e ndryshme të arrish të bojsh një një funksion të ndryshëm edhe kjo domethënë atëherë pak m’u pat përkujtu pse na thojke ai ‘82-tën, ‘83-tën që osht’ mirë, se kjo osht’ e ardhmja e na nuk e mirrshim shumë serioz për ketë çështje, se nuk na përmbushke synin me pasë një ekran të vogël edhe një kasetofon edhe me këto ti po mujshe me kry shumë funksione të ndryshme. Nuk ka pasë mundësi edhe të kemi, sepse nuk ka qenë pjesë e sistemit të arsimit, edukimit, por thjeshtë që në atë kohë veç domethënë ata hapat e para, njohuritë e para për kompjuterë edhe për informatikë kemi pasë marrë prej profesorëve tonë atëhershëm.

Dhe ajo që shpesh najherë e përmendi në kuadër të teknologjisë së vekimit osht’ edhe një lëndë e veçantë, e cila ka të bëjë me mënyrën e thurjes, thurjes të fijeve nër veti; mënyrë qysh thuren fijet, bohet njëfarë vizatimi ka lloj-lloj mënyra të thurjes edhe e disha pesë, gjashtë jonë bazë osht’ bezë, osht’ keper, osht’ atlas edhe jonë disa. Tash prej këtyne bohet njëfarë kombinimi, mënyra se si thuren fijet nër veti. Tash krejt varet ajo se çfarë funksion do të jetë ai bezi i cili në fund do të prodhohet, për çka do të përdoret edhe varësisht domethënë për çka do ta dedikojmë, ajo caktohet domethënë thurja. Por une në semestrin e katërt në këtë lëndë, u duke në semestrin e katërt edhe pestë me përcjellë që semestrin e pestë me qenë të gatshëm me dalë në provim edhe na ishin aty në atë vit t’u na ndëgju ligjërata, ishim diku nja 80 a 90 studentë.

Edhe kur fillojti profesori prej fillimit tash ai po e shpjegon mënyrën se qysh duhet të thuren fija, cila osht’ përfundi, cila osht’ përmi, pse osht’ përmi, pse osht’ përfundi edhe forma se qysh ndërliiden ata nër veti edhe ai deri sa e bojke atë vizatimin ai kur u kthejke me na pa që a jena tu vizatu, une çdo herë rrijsha sepse une veç i përgaditsha une dijsa për çka po flitet, se në shkollë të mesme i kom pasë mësu këto, këtë teknologji, këtë teknikë. Edhe kur erdhi rendi te e dyta, treta, nuk e di cila ke, ai çdo herë kur u kthejke vetëm une po rri, krejt e kanë ul krevin [kokën] po vizatojnë, vetëm une po rri. Ai me një moment erdhi rreth e rreth asaj sallës ku ishin na komplet rreth 80-90 studentë edhe kur m’u afëru prej përmasit edhe kur e pavi ai që osht’ e vizatime në mënyrë të njëjtë sikur ai që e ka vizatu se ai në momentin që e ka përmendë une e di se çka duhet me vizatu.

Ai më pati vetë, më tha, “Më falni” tha “kolegë”, tha, “çka e keni kry të mesmen?” Thashë, “Tekstilin” thashë, “edhe e kom kry domethonë vekimin”. Tha, “Ju jeni njohës i kësaj, i këtyre çështjeve?” Thashë, “Po, unë këto i kom mësu këto qysh në shkollë të mesme edhe a di për mu osht’... nuk osht’ risi se une i njoh këto sende”. Edhe gjatë ligjëratave që i kemi pasë gjatë bashkëbisedimeve që i kom pasë atëherë me profesorët, më pruni situatë te ky profesor edhe pse i ka pasë dy lëndë, në fund tha, “Nuk kom une nevojë shka ty me të thirrë në provim, se ti je njohës i këtyre seneve”. Vetëm kur erdh rendi, ai më pat qitë dhetshe në indeks, tha, “Une me ty s’kom çka me bisedu, ti je i përgatitën për këto, ti je ekspert

dhe njohës për këto çështje”. Kjo ka qenë një send e cila më ka dhanë një kurajo që bon vaki vërtetë ja vlej jom njohës i mirë, edhe i kom mësu këto sendet.

Normal, kontributi jam gjatë studimit ka qenë, kom qenë... jom mundu të jem aktiv edhe gjatë ligjëratave, edhe gjatë punës praktike, edhe gjatë kolokfiumeve që i përcjellin domethonë procesin e studimit, sepse në fund osht’, ka qenë, shumë ka qenë e rëndësishme që profesori... të përfiton njohuri për ty, sepse në fund të fundit ata kanë qenë ekspertë të njoftun të asaj kohës të ish-Jugosllavisë. Unë pi profesorëve të mi patëm dëgju se një numër serioz apo shumica e sipërmarrjeve në ish-Jugosllavi që osht’ planifiku të hapet domethonë nuk osht’, nuk osht’ bo hapja pa pëlqimin e këtyre profesorëve, apo pa kontrollin e këtyre profesorëve, apo pa programin e këtyre profesorëve.

Sepse thjeshtë kanë qenë nivelit magjistra edhe doktora shkencave edhe njohuritë kanë qenë shumë, shumë të larta sidomos për këtë pjesën e tekstit edhe komplet, me mend profesorët e mi kanë qenë profesorët edhe në Lubjanë, edhe në Zagreb, edhe në Beograd, edhe në Leskovc, edhe në Shkup. Domethonë, një profesor të cilin e ki vetëm një ditë tanë ditën shtatë, tetë ore i ki me to, ai të nesërmen osht’ në një qytet tjetër t’u ligjëru. Kanë qenë ekspertë të njoftun edhe falë atynve edhe disa njohurive, domethonë kom arritë domethonë t’i përforcojë prej shkollës mesme në studime.

Drenushë Morina: Thatë që pas përfundimit të studimeve në Beograd, keni fillu punën si menaxher i repartit të vektarisë në “Printeks”...

Osman Osmani: Po... po

Drenushë Morina: Për të vazhdu më pas si drejtor teknik, a mundeni me na përshkru pak një ditë pune në “Printeks” ashtu prej fillimit...

Osman Osmani: *Ouh!* {onomatope}

Drenushë Morina: Një kthim në kohë, hierarkia e punës, sistemi...

Osman Osmani: Më ktheve nja njëzetë vjetë mas... detyra jeme ka qenë domethonë atëherë kur jom vendos si, masi që e përfundova kohën e praktikantit mas tetë-nantë mujve edhe u vendosa si një menaxher i repartit. Detyra jeme ka qenë që... sepse prodhimi në “Printeks” ka qenë i organizum në tre ndërrime, një menaxher i repartit osht’ deshtë të ketë njohuri çka është bo në ndërrimin e tretë, ta përgatitë prodhimin për ndërrimin e parë, ta përcjellë prodhimin ndërrimit parë edhe të përgatitë procesin për ndërrimin e dytë edhe të tretin, sepse prodhimi në “Printeks” nuk ka... domethënë ka vazhdu non-stop pa ndërprerje gjithë ditëve të punës, prej të hanës deri të premtën.

Edhe përveç që orari domethënë ka fillu në ora gjashtë zyratrisht, por një menaxher nëse është deshtë ta sheh se çka është prodhu, sa është prodhu ndërrimin e tretë osht' deshtë me shku pak ma herët. Domethënë, orari jem fillojke diku pesë e gjysë, edhe njëzetë në gjashtë ma shumti u duke me kontaktu me stafin menaxhues ndihmës i cili përcillte prodhim gjatë ndërrimit tretë. Domethënë, sa është prodhu, cilat janë problemet, a kanë qenë komplet punëtorët e angazhum, a ka mungu naj punëtorë, a është deshtë të bohet naj zëvendësim, qysh kanë qenë kushtët e nxemjes, qysh s'kanë qenë, sepse njona prej çështjeve shumë të rëndësishme në teknologji është klima, qoftë në teknologjinë e hekurit, mekanikën, makinerinë, edhe në tekstil shumë osht' me rëndësi në... klima apo lagështia e temperatura në cilën prodhohet një prodhim.

Sidomos të tekstilit sepse kufijtë janë të përcaktuara edhe çdo material e ka njëfarë tepmerature dhe lagështi në nivel të lagështisë të atij vendi, asaj hapësirës. Edhe në këtë mënyrë ajo duke plotësu kriteritet, ajo i ndihmon që prodhimi të jetë përmanent edhe pa problem. Në anën tjetër, domethënë nëse nuk ka pasë nxemje mjaftueshme, pse nuk ka pasë, a ku osht' ndërprerja, a osht' naj prishje, nëse ka ndodhë naj prishje të makinës, a kemi pjesë rezervë, a duhet të porositim ato pjesë rezervë apo mund thjeshtë t'i riparim vet mjeshtri. Cilat janë pjesët, njëra prej pjesëve ma të nevojshme në prodhim sepse shpesh makina mund me ardhë te prishja edhe mjeshtri i cili menaxhon mekanikën e asaj makinës. Domethënë, thjesht ai edhe në bazë të zërit që e ndëgjon mund me ditë se ku osht' pengesa, ku është problemi.

Thjesht vjen te ndërrimi i asaj pjesës apo deri të riparimi i vogël atynve, atynve pjesëve edhe domethënë uljen e përqindjes së humbjeve, sepse domethënë çdo herë osht' deshtë me planifiku që humbjet në kohë të jenë sa më të vogla, sa me të ulëta. Ka pasë raste që vërtetë të kom, të kom, të punoj me mjeshtrë të fortë, mjeshtrit shumë vjeçar që kanë pasë njohuritë e mjaftueshme edhe shumë herë më kanë lehtësu, domethënë që problemet të cilat ndodhin me makinën, të cilat ndodhin me prodhimin ata shpejtë t'i zgjidhin edhe të vazhdohet me... domethënë, puna e asaj makinës edhe prodhimi i atij bezit i cili në disa raste osht' deshtë edhe të plotësohet afati i caktuar nëse diçka është porositë.

Për ato ka qenë shumë e rëndësishme edhe ndërrimi i tretë të përcillet, që me ndërrimin e parë të jetë i gatshëm që të jetë njëfarë takimi i mëngjesit, ku jonë [diskutu] çka kemi me prodhu, çka osht' në program, program me prodhu, a osht' plotësu deri më tani, sa është plotësu e çka duhet ma tutje, ku duhet me i dhanë rëndësi, a duhet me rritë numrin e makinave për prodhimin e një artikulli të caktuar për me përmbush obligimin për të cilën e kemi ndaj blerësit edhe sigurimi i materialit, sigurimi i punëtorëve, sigurimi... i të gjitha kushteve që i thashë. Të them kjo ka qenë kjo ka qenë dita me të cilën jom ballafaqu, plus dita jem, orari jem nuk përfundojke në dy, u duke me përfundu diku në dy e gjysmë sepse u duke me pritë edhe ndërrimin e dytë.

A kanë ardhë gjithë punëtorët në punë, a ka dikush që ka mungu me arsye, pa arsye, e tash që najkush nuk ka ardhë këtu, atëherë ti duhesh me marrë atë punëtorin e me vendos në vend të atij me urdhnu

me punu në vend të atina, sepse bon vaki ai materiali ka ma pak rëndësisjën, e ky osht' ma urgjent, sepse kemi obligim ndaj blerësit. Në këtë mënyrë osht' dashtë domethënë me planifikiku, me planifikiku a është siguru materiali mjaftueshëm për prodhimin në ndërrim e dytë edhe në ndërrimin e tretë. Najherë ndodhke edhe me ardhë edhe në pesë, gjashtë, shtatë, tetë me të thirrë najkush se ka problem, ka ndodh naj rast, naj problem shëndetësor apo nuk e di çka ose naj makinë dishka osht' prish edhe është deshtë atëherë me u përgjigjë edhe në këto raste ashtu që... edhe pse orari jem ka qenë prej gjashtëve deri në dy, por ka qenë ma së shumti ka qenë prej pesë e gjysve deri në dy e gjysmë ka qenë një orar.

Njëzetë vjet i kom kalu këtë kohë këtu, këtë rrugën këtu mbas gjimnazit deri në "Printeks" përmes hekurudhës këtu të Prizrenit. Bile, shpesh po tham masi u mbyll sipërmarrja "Printeksi" masanej u shtrujtën [u shtruan rrugët] këto që të na i thojnë Kaçanik mahalesi me kubëza, se çdo herë ka qenë kalldrëm, çdo tre muj, katër muj u duke me ble këpuca të reja se nonstop çdo ditë po shkojsh po vish u prishshin këpucët u bojshin lloq u bojshin kërrsh. Tash i kanë shtru kubëzat, thashë pse s'i kanë shtru ma herët kur shkojsha unë? Asnjëherë nuk e kemi pasë atë përparësi. Po mirë, mirë, për fat të keq nuk meti unë apet. A din e kom njëfarë nostalgji ndaj "Printeksit" jo pse nuk kom metë me punu, por thjesht edhe pse ka qenë idea fillestare atëherë që "Printeksi" të vazhdon të punon, të vepron me një program i cili do t'i planifikon një numër të caktuar punëtorëve të cilët do të vazhdojnë thojshin spinoff special qashtu e emërtojshin atë program.

Edhe i ofrohet mundësia domethënë një numër i caktuar të punëtorëve të punoj, por në fund kjo nuk u vazhdu edhe shumica e njerëzve atëherë mbeten në një pozitë të palakmueshme, pra sociale, ekonomike, që vërtetë nuk e di edhe mos me pasë ndjenja për atë gjeneratë, unë e di shumë punëtorë që kom pasë ni [ndëgju] prej një mjeshtrit të cilin e patën angazhu pas privatizimi, ai u pat... ai ka qenë punëtorë para meje domethënë ai i ka pasë, unë i kom pas njëzetë vjetë [përvojë pune] atëherë kur u pat privatizu "Printeksi" i kom pasë njëzetë, ai i ka pasë 30 vjetë përvojë punë në "Printeks" edhe e patën angazhu masi e patën privatizu. Masi që u shitë domethënë shkarkimi i gjithë atyne makinave që kanë qenë të vjetra, ai më patë thanë, "Osman" tha, "kur më kanë thirrë unë t'u kujtu se diçka do të fillohet do të organizohet edhe shkova e pranova me punu". Po tha, "Kur e pashë sipërmarrjen në repart hini" tha, "nji bager i vogël, veç i çojke makinat në hava edhe veç i lëshojke qeshtut".

Ata qysh kanë qenë prej gusit shumica prej atyne makinave, lloji i materialit gus ata u çajshin meniherë, u thejshin edhe detyra jonë u konë me i mbledhë e me i qitë në kamionë gjitha ato makinat me tona, tona, tona janë shitë si mbeturina të vjetra tha, "Une kom kajtë se 30 vjet të jetës i kom shpenzu në atë 'Printeks' edhe në fund ato 30 vjet me më përfundu me naj shkritore ka qenë katastrofë" tha. Une me të vërtetë e kom përjetu shumë keq. Kanë qenë edhe dy-tre punëtorë tjerë që kanë punu në këtë proces, shumë keq jonë ndi. Tha, "Neve na u pagun" tha, "po ndjenjat tona kanë qenë shumë shumë emocionuese", se mas qekaq viteve ti me hup krejt atë që ke prodhu. Ka qenë shumë interesante, shumë papranueshme edhe sot e sot kur i takoj ata njerëz ata ende nuk po mujnë

me besu se një gjigand qasi i madh krejt m'u shly, me qit vijë edhe me shly ato si me gome. S'ka pasë ajo vija kurrë.

Kjo është ajo njona prej dobësive që mendoj nuk osht' deshtë ashtu krejtësisht me u bo, osht' deshtë të vazhdohet, osht' deshtë të mbështetet një grup të njerëzve të punohet, ka pasë njerëz, ka ekspertë, ka njohuri. Jo me ardhë rendi tash në në Kosove të eksportojmë tekstil pa cilësi jo. Une jom dëshmitar shpesh kur dalin këta familjarë me mu ose najkon tjetër në dugojat, mu më mjafton t'i preki materialin edhe për afërsisht 90 përqind me ditë përbërjen e atina. Aq që i kom ato praktikën që e kom pasë bo edhe najherë naj dugojxhi mashtrohet a din, "Kjo o pambuk qind për qind" sene, une mjafton ta preki, ta kuptoj që nuk osht' pambuk, se ka pamuk, lloj-lloj pamuk, kemi pamuk Greqijës, Turqijës, Rusijës, po pamuku i Egjiptit osht' i cilësisë ma të lartë, materialit ma të mirë, prodhohet prej atynve, atij pamukut ose sintetike, nuk e di çka na kem mujt me vazhdu me prodhu.

Edhe me atë cilësi që e kemi pasë garantume, sigurume, që e kemi siguru për treg, e jo me na ardhë në treg gjithçka këtu. Edhe pse jonë të lira shpeshherë, jonë të dëmshme për shëndetin tonë, sepse ai dekaloron atje që osht' pamuk bon vaki që në brendësinë e tij ka sintetike ose materiale të cilat nuk i konvenojnë trupit. Mjafton ta merrni një pej prej materialit të cilit mbani edhe ta djegni që i vjen... nëse digjet shpejtë domethënë ai osht' material natyror, nëse digjet edhe formohet njëfarë kojnak [kliker], si kojnak i vogël domethënë ai material osht' sintetike brenda atij ose është përzierje. Domethënë, prej këtyre elementeve që na i kemi mësu gjatë kohës, mujm me ditë edhe me shka jemi t'u vesh e shka jemi t'u mbath. Për fat të keq që tregu jonë këtu gjithçka po bjen pa kurrfarë kontrolli, pa kurrfarë asi... po një ditë bon vaki do të bohet diçka mirë.

Drenushë Morina: Përmendet që keni punuar afër njëzetë vjet në "Printeks", a mundeni me na tregu qysh e keni përjetu lajmin kur është privatizu "Printeksi" edhe një pjesë e madhe e punëtorëve veç osht' dashtë me u largu?

Osman Osmani: Paj une, drejtë me ju tregu, une diku në vitin 2003 u pat ndëgjju, se une parzit e nisa këtë bisede, kur ka qenë idea që "Printeksi" ende si sipërmarrje të mëdhaja të cilat i kanë pasë punësu një numër serioz të qytetareve të Komunës së Prizrenit, me një program të ashtuquajtur spinoff special, i cili garantojke që një numër i garantum i punëtorëve do të vazhdojmë prodhimin. Tani, normal kjo u varë, varë osht' varë prej pronarëve të ri edhe ato çka e vendosin ata, cilat jonë kërkesat e tregut, cilat ata kanë leverdi edhe kanë gjasa të shiten edhe të krijojnë një fitim atynve, por me kusht që do të vazhdohet dishka të punohet, bon vaki jo komplet po një pjesë të bukur.

Ndërkohe, qato vitet 2003-tën unë pata ofertë prej drejtorit gjeneral edhe me pati vendosë si drejtor teknik. Ka qenë vërtetë shumë, shumë sfiduese të jesh në atë kohë drejtor teknik, duke pasë parasysht të gjitha problemet të cilat ballafaqohet "Printeksi" në 2003-tën. Prej elementit kryesor të thëngjillit, "Printeksi" ka qenë problem me siguru thëngjillin. Domethënë mundësinë për nxemje, sepse për shembull janari, shkurti, marsi ti nuk ke qenë në gjendje domethënë me siguru temperaturën e

mjaftueshme që me vazhdu prodhimin e me vazhdu kushtet e volitshme punëtoreve që ata me vazhdu punën normal, osht' deshtë thjesht me bo pauzë, me prit me u nxehtë koha edhe me fillu prodhimin mas asaj kohës, domethënë kur erdh lajmi se jo nuk do të sigurohet.

Ka qenë edhe problem edhe me siguru lëndën e parë, pambukun cilësor edhe materialet tjera me të cilat osht' marrë "Printeksi", komplet sistemi i "Printeksit" prej tjertrorës deri në ngjyrosjen deri në thurrje edhe në konfeksion nalt. Ka qenë shumë problem me siguru lëndën e parë edhe gjitha këto pak e shumë. Për fat të keq e ngadalsojshin procesin e punës. Prej tri ndërrimeve ranë në dy ndërrime, ramë në... zvogëluam orarin e punës, ramë edhe me një ndërrim, por thjesht depoja me një mënyrë patën material, patën material të mjaftueshëm për shitje, por materiali nuk u shtike sepse filloi pak një konkurrencë jo reale. Tregtarë që arritshin domethënë prej, prej Kinës, prej Turqisë, prej Bullgarisë me na pru material me çmim shumë ma të ultë edhe pse ajo ka qenë e cilësisë shumë ma të ultë.

Po edhe çmimi ka qenë shumë ma i ultë edhe ka qenë domethënë konkurrencë çmimit tonë, sepse çmimi jonë u bazojke me çmimin e pambukut që e kemi pasë ble edhe gjitha proceseve të cilat ka kalu edhe kjo. Me një mënyrë ka qenë shumë, shumë problematike që ti me arritë me shit atë materialin edhe ka pak, ka pak u detyrum domethënë të ulim numrin e punëtorëve, uljen e stafit edhe erdh puna deri te pak a shumë edhe problem me siguru mjetet për me pagu pagat. Në atë kohu kur m'u ofru mundësia domethënë të jem drejtor tekni, m unë i kërkojsha drejtorit që, "Ok, une jom njohës i proceseve teknologjike edhe do të ballafaqona domethënë prej punëtorëve të kërkoj punën dhe vazhdimin e zbatimit të punës atynve, por nëse ata punëtorë në fund të mujit nuk jonë të pagum, unë nuk kom argument qysh do t'i lypi vazhdimin e punës, angazhimin e atyne mujin e ardhshëm".

Edhe vërtetë une nja dy mujt e fundit kur më pati angazhu stafi menaxhues atëherë të jem drejtor teknik për "Printeksin", u pata mundu, u angazhova që të angazhoj punëtorë sa ma tepër punëtorë maksimum që të prodhojnë sa ma tepër. Por mas dy mujve kur erdh punam nuk kishin mjete të mjaftueshme m'i pagum thjesht isha me një situatë të palakmueshme edhe shkova drejt e te drejtori gjeneral i asaj kohë e thashë, "Ti më qite në situatë shumë të palakmueshme, une lypa punë, tash erdh fundi mujit ata po më lypin rrogë, e tash rrogë, e tash rrogë unë nuk jom përgjegjës për rroga, për rroga je ti, për rroga jonë këta të komerciales, t'financave ata osht' deshtë t'i sigurojnë rrogat e une tash qysh do të kem argument për me vazhdu angazhimin e atynve nëse nuk kemi pasë, nuk kemi pasë mundësinë m'i sigurt pagën, rrogën atynve".

Këto kanë qenë ato sfidat në kohët e fundit që me të cilat jom ballafaqu. Te une ka ndiku vërtetë shumë emotive, sepse nëse e lidhim shkollën e mesme, nëse e lidhim punën praktike, nëse e lidhim studimet, nëse e lidhim edhe punën njëzetë vjetët e fundit domethënë dikun 26-27 vjet jonë investu në "Printeks", jonë harxhu për "Printeks" edhe po vjen puna që ti nuk po ja vlejsh "Printeksit". Një kohë ka qenë goxha emotive, goxha destruktive tek unë, po nuk e di. Në atë kohë, 2003-tën veç shoqëria civile, organizatat joqeveritare, sidomos ato ndërkombëtare e patën identifiku si problem komunitetin rom, arsimin e atynve, punësimin e atynve, kthimin e atynve shumë çeshtje të cilat lidhen me këto

edhe normal lypshin partnerë të mundshëm me të cilat do të punojnë edhe do të provojnë me ndiku në ndryshimin pozitiv të komunitetit.

Une pata fat që ka pak, ka pak u pata angazhu atëherë në atë kohë, i pata marrë njohuritë e para në këtë drejtim edhe prej dikun 2003-tës, 2004-tës une jom pjesë aktive e shoqërijës civile. Jom pjesë e shumë projekteve, të cilat në mënyrë direkte punojnë me arsimin e fëmijëve, po në anën tjetër ata e bojnë njëfarë lloj punësimit të njerëzve me kohë të caktuar gjashtë muaj, një vjet. Por pak e shumë sa mos me met krejtësisht pa punë, pa angazhim. Arrinë domethënë edhe t'i ndihmojmë edhe të rinjve, edhe komunitetit në punën e atynve, në aktivitetet e atynve, në ndryshimin e atynve.

Sa kemi arritë ka hala shumë punë po duhet ta pranoj që hala ma shumë duhet të bohet, por une jom i kënaqun që ndryshimet ekzistojnë, ndryshimet kemi arritë. E përmenda edhe ma herët, unë shpesh herë e përmendi sepse e kom profesion, dhëmbëzori ka fillu, dhëmbëzori ka me ndiku te dhëmbëzortë tjerë edhe sado të mundohet me ndal një dhëmbëzore, ata tjerët kanë me vazhdu me punu, ata kanë me lëvizë dhëmbëzoret e tjerë. Edhe besoj se për një kohë të caktuar, nuk e di, nuk guxoj të them të shkurt por shpresoj që deri në dhetë, 15 vite do të kemi, do të kemi ndryshim, do të kemi një ndryshim cilësor, do të kemi njerëz shumë ma të përgatitun, ma të aftë edhe do të jemi të aftë të jemi të barabartë me të tjerët edhe të kërkojmë të drejtat e tona.

Drenushë Morina: Sipas jush, punësimi i atyre njerëzve në “Printeks” gjatë shekullit XX, domethënë, sa ka ndiku në gjendjen ekonomike të Prizrenit, në veçanti në përmirësimin e gjendjes ekonomike të komuniteti rom? Sa ka qenë pjesëmarrja e pjesëtarëve të komunitetit rom në “Printeks” domethënë të punësuar?

Osman Osmani: Une, une në statistika nuk kom të sakta, por e di që “Printeksi” ka pasë punësuar diku në maksimum deri në 3000, 2900-3000 punëtorë. Numri i pjesëtarëve të komunitetit rom besoj se ka qenë diku, mos gaboj, bon vaki dikun deri në dy, tre përqind, eventualisht pesë përqind të asaj. Nuk jom i sigurt numrin se nuk kom pasë rast të ballafaqohem me statistika, këto me hamendje duke ditë se sa njerëz kanë qenë të punësuar. Por sa ka qenë ndikimi? Ka qenë ndikimi i madh. Ka qenë ndikimi i madh nëse i marrim që tre mijë njerëz, nëse e marrin mesataren dikun një familje katër apo pesë antarëshe sigurohet ekzistenca domethënë me këto. Domethënë, na i kemi pasë siguru tri herë pesë, 15 mijë njerëz, kanë qenë me një mënyrë direkte, indirekte të sigurume me “Printeksin”, me ekzistencën e atynve.

Plus në atë kohë ka pasë edhe disa beneficione të cilat punëtorët jo vetëm të “Printeksit”, por edhe tjera sipërmarrjeve i kanë pasë para vetit. Ka qenë rroga e tremdhetë, ka qenë sindikata shumë ma e organizume, kanë qenë pushimet vjetore të organizuara. S’paku sipërmarrja ta ka siguru autobusin, nëse nuk ka mujt komplet pushimin me ta pagu, por ajo ta ka siguru pagën e tremdhetë që t’i mbulojke shpenzimet e detit, por plus t’i ka siguru edhe transportin deri në deti edhe me u kthy. Në

anën tjetër “Printeksi” ka pasë çerdhën e vet ku kanë qenë të punësuar profesionistët, edukatorët edhe ti fëmijën tande ki mujt mas pushimit të lindjes t’i dërgojsh atje.

Ka qenë një autobus apostafat për këto nonat edhe këta fëmijët të cilit i mbledhke në mëngjes edhe i dërgojke domethënë deri në çerdhe edhe ajo nona mujke domethënë me u përgjigjë detyrave, obligimeve që i ka pasë në punë. Edhe në ndërkohë, nëse u paraqitke nevoja urgjente të paraqitet tek fëmija, pa dalë prej “Printeksit” ajo ka qenë në gjendje për pesë minuta, dhetë të përgjigjet tek fëmiju i vet. Në anën tjetër “Printeksi” ka qenë asi gjigand që e patën organizu menzën e vetë, domethënë na e kemi pasë ushqimin të sigurum, s’paku një ushqim e ki pasë të sigurum. Ka pasë familje bon vaki e cila osht’ deshtë të kursen për çështjet e ndryshme edhe i mjaftojke qajo dreka qaty që e, e ka pasë gjatë punës orarit të vet. Pak e shumë i ndihmon në sigurimin edhe mjeteve, çështjeve të caktuara, domethënë kanë qenë shumë beneficione të cilat i kanë ndiku.

Kanë ndiku domethënë në njëfarë mirëqenie të mirë, të mirë mos të thom ideale, ideale por besoj që ka qenë njëfarë mirëqenie mirë. Normale që edhe fëmijët kanë qenë mundësitë të shkollohen, kanë qenë edhe në bursa atëherë në sipërmarrje, sikur që edhe une pata rast domethënë fëmijët e punëtorëve të “Printeksit” t’i jipet bursa për me mujt, me mujt ata me i vazhdu studimet e veta, shkollim e vet. Plus kanë qenë edhe momentet e caktuara vijshin tjera sipërmarrje në “Printeks”, me një mënyrë kreditore ki mujt me ble libra, ki mujt me ble... nuk e di veshmbathje komplet për një kohë të caktuar, dy, tre muj pa kamatë, domethënë me pagesë të caktuar. Ka pasë disa beneficione edhe tash ti domethënë 10-15 mijë njerëz me i lanë, jo pa beneficione, por pa paga, pa ekzistencë.

Vërtetë ka qenë... osht’ një sfidë goxha e madhe duke e ditë që shumica e atynve njerëzve jonë gjallë sot, bredhin rrugëve. Ata nuk jonë në gjendje me kontribu, nuk jonë në gjendje tash me shfrytëzu se i ka bo 50-60 vjet, ai tash nuk o as për punë të re, po në anën tjetër ai nuk din, nuk din punë tjetër me mësu. Nuk osht’ në gjendje me mësu punë tjetër edhe pse për shembull kohët e fundit pi ndëgjoj, “Edukimi gjatë gjithë jetës”, por ajt ti 60 vjeçarin mësoje tash të mësohet diçka tjetër. Domethënë, problem osht’ se ai 30-40 vjet e dishka osht’ mësu edhe ka metë qaty, mujsh ti 20-30 vjeçarin, hajde, hajde edhe 40 vjeçarin diçka me kërkun me ndryshu, diçka të re, diçka që osht’ ndryshe nga e kaluara. Ama me 60 vjeçarin s’po mun... ka normal ka ndikime negative, kanë ndikimet negative si në familje, si në reflektim.

Nji numër serioz osht’ ndiku për shembull ndërprerja e këtyne marrëdhënieve të punës, ka ndiku që edhe këto daljet largimet nga... për shembull në 2014-tën kemi pasë nji, nji largim masiv nga Kosova. Në kuadër të asaj edhe Prizreni, në kuadër të asaj edhe punëtorët, ish-punëtorët e “Printeksit”, të cilët normal nuk kanë pasë mundësi me siguru ekzistencën e vet. Ajo osht’ deshtë me siguru mundësinë për me dalë edhe për me kërkun, me siguru ekzistencën e vet. Për fat të keq që sistemet në të cilat kanë shku, qoftë të Gjermanijës, qoftë Austrijës, Zvicrës, ata nuk i kanë pranë plotësisht. Mas një kohë të caktuar p’i kthejnë tash edhe njëfarë rendi nëse është marrë, osht’ nxonë deri prej 2004-tës deri në

2014-tën ai e ka shkatërru ata fëmijët kanë metë dy vjet pa shkollë, jonë kthy prapë, a jonë nxënës të rregullt?

Ky ka metë, vazhdon apet të jetë pa punë, ka qenë pa punë edhe apet vazhdon të jetë pa punë. Njëfarë mirëqenia e atij osht' ndryshu sepse ka pa jetën në Gjermani, ka pa jetën në Austri, tash kur po kthehet këtu nuk jonë ato kushtët, nuk jonë ato mundësitë. Domethënë shumë, shumë probleme të cilat normale kanë me pasë pasojat e veta edhe matutjeshme tek njerëz, edhe pse këta po thojnë po i integrojnë njerëzit, po i qesin në rend por jo. Ka me pasë probleme shumë sepse një problem, një problem që shkaktohet menjëherë nuk i shohin pasojat, duhet disa vjet të kalojnë edhe të shihen pasojat e atynve. Për fat të keq negative, negative të cilat do të reflektohen të gjithë, tek të gjithë njerëzit në Komunën e Prizrenit.